

BANKA E SHQIPËRISË

*Revista Ekonomike*

*6M 1 - 2015*

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.  
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,  
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri  
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11  
Faks: + 355 4 2419408  
E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)*

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

*\* Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

# P Ë R M B A J T J A

<b>INDEKSI LERNER-TREGUES I FUQISË SË TREGUT TË BANKAVE NË SHQIPËRI</b>	<b>4</b>
<i>Elona Dushku</i> <i>Departamenti i Kërkimeve</i>	
<b>HARTA E STABILITETIT FINANCIAR NË SHQIPËRI</b>	<b>13</b>
<i>Arisa Saqe, Odetta Minka dhe Vasilika Kota</i> <i>Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave</i>	
<b>SFIDAT E ZBATIMIT TË BAZEL II</b>	<b>33</b>
<i>Lindita Vrioni</i> <i>Departamenti i Kërkimeve</i>	
<b>TABELAT BURIME-PËRDORIME DHE INPUT-OUTPUT TË SHQIPËRISË: STRUKTURA DHE MULTIPLIKATORËT</b>	<b>50</b>
<i>Enian Çela</i> <i>Departamenti i Kërkimeve</i>	

## INDEKSI LERNER-TREGUES I FUQISË SË TREGUT TË BANKAVE NË SHQIPËRI

*Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve*

### ABSTRAKT

*Konkurrenca në sektorin bankar ka qenë dhe mbetet një çështje me mjaft interes, jo vetëm për rëndësinë që ka për sistemin bankar dhe atë financiar, por edhe ndikimin që ka në ekonominë në tërësi. Viteve të fundit i është kushtuar më së shumti vëmendje lidhjes që ka midis konkurrueshmërisë së sistemit bankar dhe rrezikut të sistemit bankar, ndikimit në stabilitetin financiar dhe ekonominë në tërësi [Beck, (2008), Beck et al, (2012)]. Testimi i këtyre lidhjeve dhe marrja e rezultateve sa më të qëndrueshme kërkon fillimisht matjen dhe vlerësimin sa më të saktë të konkurrencës. Qëllimi i këtij artikulli është matja e konkurrencës së bankave që veprojnë në Shqipëri, bazuar në përfaqshjen jostrukturore. Vlerësimet e marra, tregojnë se gjatë periudhës 2004-2014, konkurrenca e bankave në Shqipëri është midis konkurrencës së plotë dhe asaj monopolistike.*

### I. HYRJA

Konkurrenca në sistemin bankar është një nocion kompleks, kështu, matja e saktë e saj ka sjellë në evoluimin e mëtejshëm të metodave për vlerësimin e saj. Literatura ekonomike identifikon dy përfaqshje kryesore të matjes së konkurrencës së sistemit bankar: përfaqshja strukturore dhe përfaqshja jostrukturore.

Përfaqshja strukturore (Structure-Conduct Performance paradigm-SCP) e zhvilluar fillimisht nga Mason dhe Bain (1956), tenton të shpjegojë konkurrencën midis firmave bazuar në lidhjen që ekziston midis performancës së tyre dhe karakteristikave të tregut ku ato veprojnë. Karakteristikat e strukturës së tregut përcaktohen nga numri i firmave që veprojnë në këtë treg, përmasat relative dhe absolute të firmave, numri i hyrjeve dhe i daljeve të firmave nga ky treg, si dhe hapësirat e mundshme për diferencimin e produkteve. Struktura e tregut, duke ndikuar kështu në ecurinë e firmës, përcaktimin e çmimeve dhe të vendimeve strategjike të ndërmarra prej saj, ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e firmës.

Ideja kryesore e përfaqshjes strukturore SCP është, që tregjet e përqendruar karakterizohen nga çmime dhe fitime më të larta. Nga ana tjetër, Smirlock (1985), Evanoff dhe Fortier (1988), theksojnë faktin se fitimet më të larta mund të jenë rezultat i eficiencës më të lartë në prodhim dhe në organizimin menaxherial. Për më tepër, sjellja konkurruese e firmave përcaktohet gjithashtu edhe nga kushtet e hyrjes apo të daljes në treg. Kështu, Baumol et al., (1982),

pohojnë që një industri e përqendruar mund të sillt në mënyrë konkurruese nëse pengesat për të dalë dhe për të hyrë nga ky treg janë të ulëta. Treguesit kryesorë që përdor kjo përjasje për vlerësimin e konkurrencës janë tregues të peshës së tregut, tregues të përqendrimit të tregut, indekset Herfindahl-Hirschman. Avantazhi kryesor i përdorimit të treguesve të përqendrimit ka të bëjë me numrin e vogël të të dhënave që duhet për të llogaritur këto indekse, ndërsa disavantazhi kryesor i përjasjes SCP dhe treguesve të saj është mungesa e mbështetjes teorike dhe i argumenteve ku këto tregues mbështeten. Claessens dhe Leaven (2004), theksojnë që karakteristikat strukturore të industrisë nuk mjaftojnë për vlerësimin e konkurrencës midis bankave dhe se përqendrimi dhe konkurrenca janë dy koncepte tërësisht të kundërta. Megjithatë, treguesit e përqendrimit përdoren gjerësisht nga vendet në zhvillim, pasi të dhënat në nivel banke janë të pakta dhe të një cilësie jo të mirë.

Përjasja jostrukturore ose (The New Empirical Industrial Organization-NEIO), mbështetet kryesisht në teorinë ekonomike të oligopolit dhe të modelit statik (dinamik) të konkurrencës Carbo-Valverde et al., (2009). Kështu, matësit kryesorë të konkurrencës sipas përjasjes jostrukturore janë mbështetur kryesisht në modelet e propozuar nga Lerner (1934), Bresnahan (1982), Panzar and Rose (H-statistik) (1987), Mueller (1977, 1986) dhe Boone (2008). Gjenerata e parë e treguesve të konkurrencës bazohet kryesisht në konceptin statik të konkurrencës, ku si matës të saj janë përdorur indeksi Lerner, H-statistik etj. Ndërsa, gjenerata e dytë e treguesve të konkurrencës mbështetet në konceptin dinamik të konkurrencës, zhvilluar nga Mueller (1977, 1986) dhe Boone (2008), që kanë propozuar së fundmi, indeksin Boone për vlerësimin e konkurrencës së bankave.

Në këtë artikull, do të paraqesim vlerësimin e konkurrencës së bankave në Shqipëri bazuar në indeksin Lerner. Arsyet e përzgjedhjes së këtij indeksi në krahasim me indekset e tjera, ka të bëjë me faktin që; është një tregues që mbështetet në teorinë statike të oligopolit; është i lehtë për t'u interpretuar; llogaritja e tij bazohet në të dhëna lehtësisht të aksesueshme, si dhe jep informacion nëpër vite për fuqinë e tregut, duke bërë të mundur studimin e evolimit në kohë të sjelljes së çmimit nga ana e bankave. Gjithashtu, indeksi Lerner është një tregues fleksibël dhe mund të masë fuqinë e tregut të bankave, bazuar në produkte të ndryshme bankare apo fuqinë e tregut të bankave sipas shpërndarjes gjeografike të tyre.

Indeksi Lerner është një tregues që përdoret gjerësisht për vlerësimin e fuqisë së tregut të një firme, ku fuqia e tregut e një firme vlerësohet nga divergjenca midis çmimit të firmës dhe kostos marzhinale të saj. Në një treg me konkurrencë të plotë, çmimi dhe kostoja marzhinale janë të barabarta dhe diferenca e madhe midis tyre (çmimit dhe kostos) tregon për mungesë të konkurrencës dhe rritjes së fuqisë së tregut nga ana e disa firmave të caktuara. Ndërsa si disavantazhet e tij, përmendim faktin se ai më së shumti është një tregues i fuqisë së tregut të bankave sesa një përafres i konkurrencës, pasi një rritje e fuqisë së tregut mund të jetë konsistente me një rritje të intensitetit të konkurrencës (Stiglitz, 1987, 1989). Së fundi, Boone, (2008), Boone et al. (2013), kanë treguar që nëse indeksi Lerner ulet në krahasim me konkurrencën, fuqia mesatare e

tregut mund të rritet, të ulet ose të mbetet e pandryshuar për shkak të efektit të rialokimit nga firmat eficiente tek firmat inefficente. Një tjetër disavantazh i indeksit Lerner është që supozon eficiencë perfekte teknike dhe alokuese. Megjithatë, në realitet, bankat nuk veprojnë në kushte të eficientë perfekte, duke bërë që kostot operative dhe eficienta të variojnë sipas kushteve ekonomike të vendeve ku operojnë bankat (Chaffai et al., 2001). Kështu, ndryshimet në kohë dhe midis vendeve të indeksit Lerner, mund të justifikohen me ndryshime apo diferencat që vijnë nga faktorët jokonkurrues.

Pavarësisht matësve të ndryshëm të konkurrencës në sistemin bankar në literaturën empirike dhe teorike, nuk ka një konsensus të gjerë midis matësit të konkurrencës në sistemin bankar, pasi secili prej tyre mbulon pjesë të caktuar të konkurrencës (Liu et al., 2013).

Ky artikull ka si qëllim vlerësimin e konkurrencës së bankave në Shqipëri, bazuar në metodologjinë e prezantuar nga Lerner, për të parë evoluimin në kohë të fuqisë së tregut të bankave në Shqipëri, gjatë periudhës 2004-2014.

Struktura e artikullit është e organizuar si vijon. Në pjesën në vazhdim do të paraqesim metodologjinë dhe të dhënat e përdorura për llogaritjen e indeksit Lerner. Në pjesën e tretë, paraqiten dhe diskutohen vlerësimet e marra mbi indeksin Lerner dhe së fundi, disa konkluzione.

## II. METODOLOGJIA

Ashtu siç e përmendëm në fillim, indeksi Lerner është një tregues alternativ i konkurrencës, ku avantazhi kryesor i tij është se bazohet në teorinë e çmimit ekuilibër, ndërsa një nga dobësitë e tij është që të dhënat e bilancit të bankave përdorur për vlerësimin e çmimit dhe të kostos janë përafërues të tyre, duke e bërë të debatueshëm përzgjedhjen e tyre (Bikker et al., 2007).

Për vlerësimin e konkurrencës së sektorit bankar në nivel banke ashtu si, Fernandez de Guevara et al (2005), Jimenez, Lopez dhe Saurina (2007) dhe Berger et al (2009), kemi llogaritur indeksin Lerner për secilën nga bankat në çdo periudhë si më poshtë:

$$L\_Lerner_{(i,t)} = (P_{(i,t)} - MC_{(i,t)}) / P_{(i,t)} \quad (1)$$

Ku  $P_{(i,t)}$  është çmimi i totalit të aktiveve matur si raport të ardhurave totale (të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga jointerеси) ndaj totalit të aktiveve për bankën i në periudhën t. Ndërsa  $MC_{(i,t)}$  është kostoja marzhinale e totalit të aktiveve të bankës i në periudhën t, të gjeneruar nga funksioni trans log i kostove të bankës sipas Berger et al (2009), ku kostoja totale e bankës  $C_{(i,t)}$  është funksion i një prodhimi të vetëm,  $Q_{(i,t)}$  dhe e tre çmimeve të inputit  $w_{(i,t)}^j$ , ku  $j \in (1, 2, 3)$ . Në mënyrë më të detajuar, funksioni i trans log i kostove është përcaktuar si më poshtë:

$$\ln C_{(i,t)} = \alpha_0 + \alpha_1 \ln Q_{(i,t)} + 1/2 \alpha_2 (\ln Q_{(i,t)})^2 + \sum_{j=1}^3 \beta_j \ln w_{(i,t)}^j + \sum_{j=1}^3 \sum_{k=1}^3 \beta_{(j,k)} \ln w_{(i,t)}^j \ln w_{(i,t)}^k + \sum_{j=1}^3 \gamma_j \ln w_{(i,t)}^j \ln Q_{(i,t)} + \varepsilon_{(i,t)} \quad (2)$$

Ku  $C_{(i,t)}$  është kostoja totale për secilën bankë, që përfshin shpenzimet për interesa, shpenzimet e personelit dhe shpenzime të tjera. Ndërsa prodhimi i bankës  $Q_{(i,t)}$  është përafëruar me totalin e aktiveve të bankës për  $i$  në kohën  $t$  (Fernandez de Guevara, Maudos and Perez, 2005). Tre janë çmimet kryesore të inputit  $w_{(i,t)}^j$  që përdoren: çmimi i kostove fikse  $w_1$ , llogaritur si raport i shpenzimeve të tjera operative dhe administrative ndaj totalit të aktiveve, çmimi i punës  $w_2$ , llogaritur si raport i shpenzimeve të personelit ndaj totalit të aktiveve dhe çmimi i fondeve të dhëna hua  $w_3$ , matur si raport i shpenzimeve të interesit ndaj totalit të depozitave dhe të fondeve të tregut të parasë.

Koeficientët e marrë nga vlerësimi i funksionit të trans log të koston (ekuacioni i 2) janë përdorur për të llogaritur koston marzhinale (ekuacioni 3). Ashtu si Berger et al, (2009) dhe Beck et al, (2012) kemi supozuar që çmimet e inputeve janë homogjene, kështu, kostoja marzhinale është llogaritur si më poshtë:

$$MC_{(i,t)} = C_{(i,t)} / Q_{(i,t)} [\alpha_1 + (\alpha_2) \ln Q_{(i,t)} + \sum_{j=1}^3 \gamma_j \ln(w_{(i,t)}^j) / (w_{ii}^3)] \quad (3)$$

Indeksi Lerner merr vlerat midis 0 dhe 1, kur çmimi barazon koston marzhinale, pra  $P = MC$ , indeksi Lerner merr vlerën 0 dhe firma nuk ka fuqi të vendosjes së çmimit, pra bankat veprojnë në konkurrencë të plotë, ndërsa kur indeksi Lerner merr vlerën 1, tregon që bankat veprojnë në kushte monopoli (Turik-Ariss, 2009). Indeksi Lerner është një tregues invers i konkurrencës, pra një vlerë e lartë e indeksit tregon konkurrencë të ulët dhe anasjellat (Pruteanu- Podpiera et al., 2007).

### III. REZULTATET

Gjithashtu, kemi llogaritur edhe indeksin Herfindahl-Hirschman (HH), tregues i përqendrimit të sektorit bankar për të bërë diferencën midis informacionit të marrë nga ky indeks dhe indeksit Lerner. Ky indeks llogaritet si raport i peshës së aktiveve të secilës bankë ndaj totalit të aktiveve, në fuqi të dytë (Bikker dhe Haaf, (2000).


$$HH_{it} = \sum_{i=1}^n (q_i / Q)^2 \quad (4)$$

Vlerat e këtij indeksi variojnë midis  $1/n$  dhe 1, ku vlera më e vogël i korrespondon faktit që të gjitha bankat kanë përmasa të njëjta dhe merr vlerën 1 në rast monopoli. Zakonisht vlerat e këtij indeksi shumëzohen me 10,000, ku një vlerë e indeksit HH poshtë 1000 tregon për një nivel të ulët të përqendrimit të bankave, një vlerë e indeksit midis [1,000-1,800] tregon për një nivel të moderuar të përqendrimit të bankave. Një vlerë e indeksit HH



mbi 1,800 tregon një përqendrim të lartë të sektorit bankar, ndërsa një vlerë e indeksit e barabartë me 10,000 tregon praninë e monopolit.

Grafik 1. Ecuria e indeksit HH



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit.

Rezultatet e marra janë paraqitur si më poshtë, ku përgjithësisht vihet re një trend rënës i indeksit HH, që nënkupton një ulje të përqendrimit të tregut nga ana e bankave.

Vlerësimet tregojnë që kryesisht gjatë periudhës 2004-2006, kemi pasur një nivel të lartë të përqendrimit të bankave, ndërsa nga viti 2007 e deri në vitin 2014, vihet re një nivel i moderuar i përqendrimit të bankave.

Për llogaritjen e Indeksit Lerner kemi përdorur të dhënat individuale të bilanceve të bankave, që veprojnë në Shqipëri, gjatë periudhës 2004-2014. Në tabelën më poshtë janë paraqitur disa statistika përshkruese të të dhënave të agreguara të përdorura për llogaritjen e indeksit Lerner.

Tabela 1: Statistikat përshkruese të treguesve<sup>1</sup>

	Mesatarja	Median	Maksimumi	Minimumi	Devijimi Standard
$P_{(i,t)}$ - çmimi i aktiveve	0.132	0.079	1.705	0.041	0.189
$w_1$ - çmimi i kostove fikse	0.061	0.001	1.646	0.000	0.192
$w_2$ - çmimi i punës	0.037	0.036	0.126	0.011	0.016
$w_3$ - çmimi i fondeve të dhëna hua	0.015	0.011	0.064	0.003	0.011
$C_{(i,t)}$ - kostoja totale	55,983	31,203	319,150	745	71,910
$Q_{(i,t)}$ - totali i aktiveve	4,611	1,386	78,307	48	9,470
Nr. i vëzhgimeve	165	165	165	165	165

Burimi; Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit.

Për të llogaritur indeksin Lerner, fillimisht kemi vlerësuar ekuacionin 2 dhe më pas ekuacionin 3. Rezultatet e vlerësimit të funksionit trans log janë paraqitur në tabelën 3, kostoja totale e bankave është shprehur si funksion i prodhimit dhe i tre çmimeve si input. Vlerësimi i ekuacionit është bërë me anë të metodës 2SLS në panel me efekte fikse, për të shmangur problemet e endogjenitetit midis variablave, ku si tregues instrumentalë kemi përdorur treguesit shpjegues me një vonesë kohore. Rezultatet e testit të J-statistik, tregojnë që nuk kemi problem me indentifikimin e instrumenteve të përdorur.

<sup>1</sup> Të dhënat janë vjetore për 15 bankat që veprojnë në Shqipëri, të cilat përbëjnë 90% të totalit të aktiveve të sistemit bankar.



Tabela 2: Vlerësimi i funksionit trans log të kostos

Variablat shpjegues	Variabli i varur $\ln C_{(i,t)}$	
	Metoda: Panel Two-Stage Least Squares-Fixed effects	
	Koeficienti	Probabiliteti
$\alpha_0$	-5.383062***	0.0013
$\ln Q_{(i,t)}$	2.589416***	0.0000
$\ln Q_{(i,t)}^2$	-0.184106***	0.0000
$\ln w_{(1,t)}$	0.605009***	0.0000
$\ln w_{(3,t)}$	-2.080289***	0.0001
$\ln w_{(1,t)} * \ln w_{(3,t)}$	-0.079235***	0.0008
$\ln w_{(1,t)}^2$	0.064057***	0.0000
$\ln w_{(2,t)}^2$	-0.297986***	0.0004
$\ln Q_{(i,t)} * \ln w_{(1,t)}^2$	-0.018914	0.1083
$\ln Q_{(i,t)} * \ln w_{(2,t)}^2$	0.282586***	0.0000
R-squared	0.994907	
Adjusted R-squared	0.993977	
S.E. of regression	0.144123	
F-statistic	103.2884	
Prob(F-statistic)	0.000000	
Instrument rank	25	
Mean dependent var	11.74992	
S.D. dependent var	1.857039	
Sum squared resid	2.617195	
Durbin-Watson stat	1.699975	
Second-Stage SSR	25.88063	
Prob(J-statistic)	0.120628	

Burimi: Llogaritje të autorit.


Koeficientët e marrë nga vlerësimi i funksionit trans log të kostos, të cilët kanë rezultuar statistikisht të rëndësishëm janë përdorur për të llogaritur koston marzhinale MC (ekuacioni 3). Mbas gjenerimit të koston marzhinale, kemi llogaritur indeksin Lerner për secilën nga bankat dhe në çdo periudhë. Ecuria e indeksit Lerner për të gjithë sistemin bankar është dhënë në grafikun 2. Llogaritja e indeksit Lerner për secilin vit është llogaritur si mesatare e thjeshtë e indekseve Lerner për çdo bankë, ku secila bankë është peshuar njëllë.

Tabela 3: Indeksi Lerner

	Mesatarja	Median	Devijimi Standard
2004	0.451	0.467	0.186
2005	0.507	0.560	0.156
2006	0.479	0.470	0.176
2007	0.480	0.468	0.149
2008	0.398	0.436	0.193
2009	0.393	0.401	0.217
2010	0.467	0.545	0.248
2011	0.492	0.513	0.267
2012	0.486	0.473	0.264
2013	0.503	0.477	0.278
2014	0.572	0.585	0.309
2004-2014	0.475	0.490	0.222

Burimi: Llogaritje të autorit.

Grafik 2. Ecuria e çmimit të aktiveve, kostos marzhinale dhe indeksi Lerner



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit.

Vihet re se privatizimi i ish-Bankës së Kursimeve është shoqëruar fillimisht me një rritje të indeksit Lerner, pra një përkeqësim të konkurrencës dhe më pas nga viti 2005 deri në vitin 2009 vërehet një rënie e indeksit. Vlerësimet tregojnë se gjatë kësaj periudhe vihet re një rritje e konkurrencës midis bankave dhe uljes së fuqisë së tregut nga ana e tyre. Kjo ka ardhur si rezultat i uljes së çmimit të aktiveve, ashtu edhe të kostos marzhinale (grafiku 2). Ndërsa mbas vitit 2009, vërehet një rritje e indeksit Lerner, që tregon për një ulje të konkurrencës nga ana e bankave. Kjo tendencë është ndikuar nga ecuria rritëse e çmimit të aktiveve, përkundrejt tendencës rënëse të kostos marzhinale. Përgjithësisht, në terma mesatarë, mund të themi që konkurrenca në sistemin bankar është midis konkurrencës së plotë dhe monopolit.

#### IV. KONKLUZIONE

Rëndësia e sektorit bankar për ekonominë në tërësi dhe konkurrenca e bankave midis tyre, ka qenë dhe mbetet një çështje e rëndësishme për vendimmarrësit në çdo kohë. Kriza e fundit financiare solli edhe një herë në vëmendje rolin e rëndësishëm, që ka konkurrenca dhe stabiliteti bankar-financiar për të gjithë ekonominë. Për më tepër, konkurrenca në sektorin bankar është më e veçantë se konkurrenca në sektorët e tjerë për shkak të impaktit që ajo ka në stabilitetin financiar, eficiencën dhe aksesin e shërbimeve financiare (Claessens (2009)). Kështu, shumë studime tentojnë të vlerësojnë impaktin që ka konkurrenca në sistemin bankar, ku vlerësimi i një treguesi sa më të mirë të konkurrencës është një hap mjaft i rëndësishëm. Literatura identifikon dy përfaqesja kryesore për matjen e konkurrencës, përfaqesjen strukturore dhe atë jostrukturore. Përfaqesja strukturore e vlerëson konkurrencën, bazuar në strukturën e tregut, ndërsa përfaqesja jostrukturore e vlerëson konkurrencën e firmave duke vlerësuar sjelljen e firmave në një treg të caktuar.

Ky artikull propozon përdorimin e matësve jostrukturorë për vlerësimin e konkurrencës së sistemit bankar në rastin e Shqipërisë, përkundrejt përdorimit të treguesve të përqendrimit. Duke qenë se secili nga treguesit e propozuar nga përfaqesja jostrukturore bazohet në supozime të ndryshme, secili prej tyre mat elementë të ndryshëm të konkurrencës, kështu nuk ka një konsensus se cili nga treguesit është më i mirë.

Në këtë artikull, paraqesim vlerësimin e konkurrencës bazuar në indeksin Lerner, që është një matës i fuqisë së tregut të bankave. Arsyet e zgjedhjes së këtij indeksi, përkundrejt treguesve të tjerë, kanë të bëjnë me faktin që ai është matës më i mirë i konkurrencës sesa treguesit e përqendrimit, bazohet në teorinë e oligopolit dhe mund të llogaritet për bankat në mënyrë individuale për të parë evoluimin në kohë të tij.

Vlerësimet e indeksit Lerner për 15 bankat e sistemit bankar, që përbëjnë rreth 90% të totalit të sistemit bankar, tregojnë që mesatarisht ky indeks për të gjithë periudhën është në nivelin 0.48, pra nuk jemi as në situatë monopoli e as në situatë të konkurrencës së plotë, por diku në mes, me një fuqi tregu të moderuar. Gjatë periudhës 2004-2009, vihet re një rënie e indeksit Lerner që tregon për një ulje të fuqisë së tregut të bankave dhe rritje të konkurrencës, ndikuar si nga ulja e çmimeve të aktiveve ashtu edhe të kostove marzhinale. Ndërsa nga viti 2009 dhe deri në vitin 2014, vihet re një tendencë rritëse e indeksit Lerner, që nënkupton një rritje të fuqisë së tregut nga ana e bankave dhe ulje të konkurrencës. Kjo tendencë është ndikuar nga një ulje e kostos marzhinale të bankave nga njëra anë, por edhe nga një rritje e çmimeve të aktiveve, si rrjedhojë e përkeqësimit të kushteve makroekonomike, shtimit të pasigurisë në treg dhe asimetrisë së informacionit.

Megjithatë, në interpretimin e rezultateve duhet të mbajmë parasysh që indeksi Lerner është më së shumti një tregues i fuqisë çmim-përcaktues së firmës sesa i konkurrencës, si dhe të konsiderojmë kufizimet e këtij indeksi gjatë analizimit të ecurisë së tij.

## REFERENCA

- Beck, Th., (2008), "Bank competition and financial stability: Friends or Foes?" World Bank, Policy Research Working Paper, 4656,
- Beck, Th., De Jonghe, O., and Schepens, G.,(2012) " Bank competition and stability.: cross country heterogeneity"; .European Banking Center Discussion Paper,2012-026, 2012
- Beck, Th., De Jonghe, O., and Schepens, G.,(2012) . "Bank Competition and stability:cross country heterogeneity.» European Banking Center Discussion Paper,2012-026, 2012.
- Demircuc-Kunt, A. and Peria, M. (2010)." A framework for analyzing competition in the banking sector : an application to the case of Jordan". World Bank Policy Research Working Paper, 5499.
- Baumol, W. J., Panzar, J. C., and Willig, P. (1982). "Contestable Markets and the Theory of Industry Structure. Harcourt Brace Jovanovich.
- Claessens, S. and Laeven, L. (2004)." What drives bank competition ? Some international evidence". *Journal of Money, Credit and Banking*, 36(3) :563{583.
- Carbo-Valverde, S., Humphrey, D., Maudos, J., and Molyneux, P. (2009). "Cross-country comparisons of competition and pricing power in European banking". *Journal of International Money and Finance*, 28(1) : 115{134.
- Lerner, A. (1934)." The concept of monopoly and the measurement of monopoly power." *The Review of Economic Studies*, 1(3) :157{175.
- Bresnahan, T. (1982). "The oligopoly solution concept is identified". *Economics Letters*, 10(1-2) :87{92.
- Panzar, J. and Rosse, J. (1987)."Testing for monopoly equilibrium. *The Journal of Industrial Economics*, XXXV(4) :443{456.
- Mueller, D. C. (1977). "The persistence of profits above the norm". *Economica*, 44(176) :369{380.
- Mueller, D. C. (1986)." Profits in the long run". Cambridge University Press.
- Boone, J. (2008). "A new way to measure competition". *The Economic Journal*, 118(531) :1245{1261.
- Stiglitz, J. E. (1987)." Competition and the number of firms in a market: Are duopolies more competitive than atomistic markets ? " *The Journal of Political Economy*, 95(5) :1041{1061.
- Boone, J., van Ours, J. C., and van der Wiel, H. (2013). " When is the price cost margin a safe way to measure changes in competition ?" *De Economist*, pages 1{23.
- Liu, H., Molyneux, Ph., and Wilson, J.,. "Competition and stability in european banking: a regional analysis." *The Manchester School*, Vol 81, Issues 2, 2013: 176-201.
- Fernandez de Guevara, Maudods and Perez, (2005)."Market Power in European banking sectors"2005
- Jimenez, G., Lopez, J. A and Saurina, J.,. (2007), «How does competition impact bank risk-taking?» Federal Reserve Bank of San Francisco, Working Paper Series, 2007-23, 2007.
- Berger, A., Klapper, L, and Turk-Ariss, R.,(2009). "Bank competition and financial stability." *Journal of Financial Services Research* 35(2), 2009.
- Turik-Ariss, Rima (2009). "On the implications of the market power in banking: Evidence from developing countries.» ERF 16 Annual Conference . Cairo, Egypt, 2009.
- Vivies, X.,(2010),"Competition and stability in banking" IESE Business School-University of Navarra, Working Paper: 852, 2010.

# HARTA E STABILITETIT FINANCIAR NË SHQIPËRI

*Arisa Saqe, Odeta Minka dhe Vasilika Kota<sup>1</sup>*  
*Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave*

## HYRJE

Vlerësimi i stabilitetit financiar vijon të mbetet një ndër elementët më të vështirë për të gjitha bankat qendrore, të cilat aktualisht e kanë përfshirë këtë objektiv në detyrat kryesore të mandatit të tyre. Në mungesë të një treguesi të vetëm, i cili përmbledh zhvillimet në sistemin financiar, si dhe përcakton nëse ky sistem është në kushte stresi, bankat qendrore kanë ndërtuar metoda të ndryshme vlerësimi<sup>2</sup>.

Qëllimi i këtij materiali është të prezantojë një mënyrë të re të përpunimit të informacionit, që vjen nga rreziqe të ndryshme me të cilat përballet sistemi financiar, në një matës të vetëm. Ky matës njihet si Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) dhe prezanton kushtet dhe rreziqet kryesore të stabilitetit financiar në një vend apo më gjerë. Për ndërtimin e kësaj harte jemi bazuar në metodologjitë e prezantuara nga FMN-ja sipas Dattels et al. (2010), Banka e Norvegjisë sipas Dahl et al. (2011) dhe Banka e Zelandës së Re nga Bedford dhe Bloor (2009).

Materiali është i strukturuar si në vijim: Seksioni i parë prezanton teorikisht mënyrën e ndërtimit të një diagrame "rrjetë"<sup>3</sup> (Cob Web), seksioni i dytë prezanton metodologjinë e matjes së nivelit të rrezikut, ndërkohë që seksioni i tretë detajon ndërtimin e hartës së stabilitetit financiar për rastin e Shqipërisë. Seksioni i katërt përshkruan ecurinë faktike dhe performancën e HSF-së dhe seksioni i pestë paraqet përfundimet e materialit dhe propozimet për punën e ardhshme kërkimore.

## 1. NDËRTIMI I NJË DIAGRAME "RRJETË" PËR STABILITETIN FINANCIAR

Qëllimi i përdorimit të një diagrame "rrjetë" në analizat e stabilitetit financiar, e njohur shpesh si "Harta e Stabilitetit Financiar" (HSF), është: së pari, paraqitja në mënyrë të përmbledhur e fushave kryesore, të cilësuar "kategori" që

<sup>1</sup> Autorët i janë mirënjohës asistencës dhe komenteve nga Elvida Orhan, Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave.

<sup>2</sup> Dahl et al. (2011), përmbledh metodologjitë kryesore të përdorura në bankat qendrore në lidhje me treguesit e vlerësimit të stabilitetit financiar.

<sup>3</sup> Diagramat "rrjetë" të njohura dhe si diagramat/grafikët "radar" ose "merimangë", janë një formë paraqitjeje dydimensionale e një grupi të dhënash, që mund të jenë sasiore dhe cilësore dhe që shërbejnë për të bërë një analizë performace në një moment të caktuar kohe. Të dhënat standardizohen në mënyrë të tillë që të bëhen të krahasueshme me njëra-tjetrën dhe të mund të përdoren në ndërtimin e "rrjetës". Këto lloj diagramash janë përdorur vazhdimisht në fusha të ndryshme si në menaxhim, bujqësi, industri etj., por së fundmi, kanë gjetur përdorim dhe në analizat e stabilitetit financiar të bankave qendrore.

përbëjnë burime rreziqesh potenciale ndaj stabilitetit, dhe së dyti, ndjekja në kohë e mënyrës si evoluojnë këto burime rreziqesh. Çdo "kategori" ndërtohet nga një grup nëntreguesish, që gjykohen si më të përshtatshëm në reflektimin e rrezikut apo dobësisë ndaj stabilitetit që lidhet me këtë kategori. Përzgjedhja dhe më pas ndërtimi i kategorive dhe nëntreguesve përbërës varen nga struktura e ekonomisë dhe e sistemit financiar, si dhe gjykimi i vetë autorëve. Për këtë arsye, diagramat "rrjetë" të bankave të ndryshme qendrore kanë forma dhe paraqitje të ndryshme<sup>4</sup>. Gjithsesi, ka disa kritere kryesore që mbahen parasysh në përzgjedhjen e kategorive dhe nëntreguesve përbërës të një harte të stabilitetit dhe që Dattels et. al (2010) i shpjegojnë si më poshtë:

- a. HSF-ja përmbledh në një mjet të vetëm disa tregues rreziku për të plotësuar informacionin ekzistues në lidhje me stabilitetin financiar. Si e tillë, ajo shërben për të nxitur diskutimet rreth rreziqeve kryesore ndaj stabilitetit financiar dhe nuk synon të përcaktojë gjendjen e tij. Në këtë këndvështrim, HSF-ja duhet të përdoret së bashku me instrumentë të tjerë të ndërtuar për vlerësimin e stabilitetit financiar pa iu mbivendosuar atyre;
- b. HSF-ja duhet të përfshijë të dhëna me frekuencë të shpeshtë, të cilat mundësojnë përditësimin e saj në mënyrë të rregullt, duke përfshirë gjithashtu edhe elementë parashikues;
- c. HSF-ja synon të ofrojë informacion diagnostikues në lidhje me zhvillimet ekonomike dhe financiare, që përfshin jo vetëm teknikën përkatëse por edhe gjykimin e ekspertëve;
- d. Nëntreguesit e përfshirë në secilën kategori të hartës, duhet të ofrojnë informacion të mjaftueshëm, por të jenë të kufizuar në numër. Në rast se përfshihet një numër i vogël treguesish, informacioni i ofruar mbi zhvillimin e rreziqeve të ndryshme do të jetë i pamjaftueshëm. Nga ana tjetër, përfshirja e një numri të madh treguesish e mbivendos informacionin e ofruar, duke kundërpeshuar njëri-tjetrin. Për këtë arsye, këshillohet që numri i treguesve përbërës të çdo kategorie të jetë nga 4 deri në 8;
- e. Kategoritë përbërëse të HSF-së duhet të përmbajnë rreziqe lehtësisht të identifikueshëm nga njëri-tjetri, të matshëm dhe të rëndësishëm për stabilitetin financiar;
- f. Detajimi i treguesve të secilës kategori mund të jetë i vështirë, pasi mund t'i përkasin disa kategorive njëkohësisht. Gjithsesi, rëndësia e informacionit që ofron secili mund ta justifikojë këtë përfshirje.

## 2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT SIPAS NOTAVE TË RREZIKUT

Pas përzgjedhjes së kategorive kryesore dhe e nëntreguesve përkatës mbi të cilat do të ndërtohet HSF-ja, momenti i dytë është "konvertimi" i vlerave të serive të nëntreguesve në nota rreziku dhe më pas agregimi i serive të notave në një seri të vetme për secilën kategori. Përpara procesit të vlerësimit me nota, për çdo nëntregues gjykohet nëse rritja (ose ulja) e vlerave të serisë sjell rritje (ose rënie) të rrezikut apo e kundërta. Pra, gjykohet nëse vlerat e serive të

<sup>4</sup> Harta e Stabilitetit Global ndërtuar nga FMN-ja përmban 6 kategori (Dattels et. al, 2010), harta e Bankës së Norvegjisë përmban 8 kategori (Dahl et.al, 2011), harta e Bankës së Zelandës së Re përmban 5 kategori, (Bedford dhe Bloor, 2009).

secilit nëntregues ecin në të njëjtin drejtim me notat e rrezikut dhe në këtë rast, kahu i vlerësimit do të quhet "i drejtë" apo në drejtime të kundërta, ku kahu i vlerësimit do të konsiderohet si "i anasjellë".

Më pas, bëhet caktimi i notave të rrezikut dhe për këtë literatura sugjeron dy metoda kryesore: "metoda standarde" me percentile dhe "metoda alternative"<sup>5</sup>. Sipas "metodës standarde", seritë kohore të nëntreguesve përbërës të secilës kategori renditen në rend rritës dhe më pas seria ndahet në 11 nëngrupe të barabarta (percentile). Nëngrupi i parë ka vlerat më të ulëta të serisë kohore, ndërsa nëngrupi i 11-të, vlerat më të larta. Sipas kahut të vlerësimit të serisë (i drejtë apo i anasjellë), këto 11 percentile marrin nota vlerësuese nga 0 (percentili i parë) në 10 (percentili i fundit) ose e anasjella. Mesatarja/mediana e secilit nëntregues merr notën 5, që nënkupton vlerën mesatare të vlerësimit të serisë dhe jo një rrezik "normal". Ky hap thekson edhe njëherë rëndësinë e përfshirjes së nëntreguesve me seri të gjata kohore, që përfshijnë mundësisht disa cikle ekonomike dhe financiare. Kjo kohëzgjatje është e ndryshme për nëntregues të ndryshëm. Avantazhi kryesor i "metodës standarde" është transparencja dhe thjeshtësia në përdorim. Gjithashtu, ajo nuk varet nga supozimet në lidhje me formën e shpërndarjes së të dhënave, një element i rëndësishëm ky për disa të dhëna të cilat nuk paraqesin një shpërndarje normale. Aplikimi i kësaj metode vlerësimi nuk është i përshtatshëm në rastet kur të dhënat kanë shpërndarje shumë të gjerë dhe vlera ekstreme, pasi luhatje të vogla të serisë mund të përkthehen në luhatje të mëdha të notave të rrezikut, gjë që do të shtrembëronte realitetin. Në këto raste, Dahl et.al (2011) përdorin një "metodë alternative", ku gjatësia e serisë së vlerave të nëntreguesit (diferenca midis vlerës maksimale dhe minimale) ndahet në një numër të caktuar intervalesh me gjatësi të barabartë dhe më pas caktohen notat e rrezikut, sipas kahut përkatës të vlerësimit. Në disa raste, rekomandohet edhe vendosja a priori e kufijve të poshtëm dhe të sipërm, të cilët marrin përkatësisht vlerësimet ekstreme 0 dhe 10, ndërsa vlerësimi nga 1 në 9 u jepet vlerave brenda kufijve.

Pas konvertimit të serive të nëntreguesve në nota rreziku, seritë e notave të përfuara agregohen për çdo kategori. Në literaturë, rekomandohet që agregimi të bëhet me mesatare të thjeshtë, duke i dhënë të njëjten peshë çdo nëntreguesi. Kjo sepse përcaktimi i peshave të ndryshme për çdo nëntregues brenda një kategorie do të shtonte subjektivitetin e hartës dhe do të vështirësonte gjykimin. Nga ana tjetër, peshat mund të ndryshojnë në kohë në varësi të zhvillimeve të nëntreguesve. Kjo do të komplikonte diskutimin mbi ecurinë e HSF-së, pasi do të ishte e vështirë të identifikohesh nëse rritja e një rreziku vjen nga ecuria e nëntreguesit apo prej supozimit lidhur me peshën e tij.

Së fundi, për vetë natyrën e nëntreguesve, ata mund të përfshihen në disa kategori njëkohësisht, për shembull: rritja e raportit të kredive me probleme të individëve, nënkupton edhe rritje të rrezikut njëkohësisht në kategorinë e individëve, por edhe të sektorit bankar. Kjo lloj mbivendosjeje është e vështirë të eliminohet, ndaj pavarësisht peshës së njëjtë, informacioni i përdorur mund të nënkuptojë një mbivlerësim të një nëntreguesi në mënyrë të pavullnetshme. Pasi përfundon ndërtimi i çdo kategorie, ato mund të bashkohen në një moment

<sup>5</sup> Dattels et. al (2010); Dahl et al. (2011).



të caktuar kohor për të formuar një diagramë të rreziqeve të njohur shpesh si Harta e Stabilitetit Financiar.

Në lidhje me përditësimin e saj dhe rrjedhimisht edhe të notave, përfaqja e përdorur nga FMN-ja rekomandon që të ruhet krahasueshmëria e HSF-së në kohë. Kjo nënkupton se me shtimin e të dhënave, mesatarja e re e nëntreguesve pavarësisht se mund të tejkalojë vlerën historike, të mos rivlerësohet me notën 5, por të ruhet e njëjta mënyrë vlerësimi përmes notave. Ndërkohë, Dahl et al. (2011), sugjerojnë që për përditësimin e HSF-së, renditja me percentile të bëhet duke përfshirë edhe të dhënat e reja. Kjo nënkupton që një nëntregues i caktuar që mund të ketë pasur për shembull notën 5, të mund të marrë një vlerësim të ri. Rrjedhimisht, ndryshimi i notës në hartën përfundimtare për një kategori të caktuar mund të ndodhë sepse ka ndryshuar rreziku apo vulnerabiliteti i saj ose sepse ka ndryshuar vlera mesatare e të dhënave. Këto dy efekte mund të jenë të identifikueshme nga njëri-tjetri nëse HSF-ja përditësohet fillimisht me metodën e parë (FMN) dhe më pas me rivlerësimin e mesatares së të dhënave. Në kushtet e një krize të fortë financiare, metoda e Dahl et al. (2011) siguron pikërisht përfshirjen e plotë të këtij informacioni të ri në Hartën e Stabilitetit Financiar, ndaj propozojmë përdorimin e kësaj metode.

### 3. NDËRTIMI I HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR PËR SHQIPËRINË

Për ndërtimin e HSF-së për Shqipërinë, jemi munduar të veçojmë burimet kryesore të rreziqeve apo dobësive që vijnë nga sektori bankar, si pjesa më dominuese e sistemit financiar dhe nga jashtë sektorit, të lidhura me zhvillimet e përgjithshme ekonomike dhe agjentët kryesorë ekonomikë. Në këtë logjikë, janë përzgjedhur 8 kategori: 3 të lidhura me karakteristikat dhe strukturën e sektorit bankar ("kapitalizimi dhe përfitueshmëria e bankave", "likuiditeti dhe financimi i bankave"; "struktura e sektorit bankar") dhe 5 kategori jashtë sektorit bankar ("zhvillimet në ekonominë e brendshme", "zhvillimet në mjedisin e jashtëm", "individët", "bizneset" dhe "qeveria").


Këto 8 kategori (Figura 1) përmbledhin në mënyrë të plotë burimet e brendshme dhe të jashtme të rreziqeve ndaj stabilitetit të sistemit tonë financiar dhe ndërtimi i HSF-së prezantohet si funksion i kategorive dhe nëntreguesve përkatës:

$$HSF: f = (K_1, K_2, \dots, \dots, K_8)$$

$$\text{ku } K_j: f = (T_1, T_2, \dots, \dots, T_j)$$

Në diagramën e mësipërme (Figura 1), lëvizja nga qendra drejt skajeve nënkupton rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar, të lidhur me kategorinë përkatëse, gjë që sinjalizon nevojën për diskutim të këtyre zhvillimeve. Secila kategori përmban 4 ose më shumë nëntregues, gjithsej 38 seri nëntreguesish.

Figurë 1. Harta e Stabilitetit Financiar për Shqipërinë



Burimi: Autorët.

Një kriter i rëndësishëm në përzgjedhjen e nëntreguesve është pikërisht shtrirja në kohë e serive të të dhënave. Ato duhet të jenë mjaftueshëm të gjata për të siguruar përfshirjen e disa cikleve apo krizave të ndryshme financiare (Dahl et al. 2011). Ky kriter në rastin tonë është disi më i vështirë për t'u plotësuar, pasi disa seri janë të shkurtra. Përgjithësisht në rastin e Shqipërisë, vlerësohet se krizat e viteve 1997, 2002 dhe së fundi 2008, janë pikat kyçe në të cilat treguesit kryesorë financiarë dhe ekonomikë reflektojnë thyerje, si rrjedhojë e krizave financiare të brendshme apo botërore. Seritë e përfshira janë tremujore, frekuencë e mjaftueshme për të siguruar përditësimin e rregullt dhe të shpeshtë të hartës. Kjo mënjanon nevojën e interpolimit të tyre, problem i hasur shpesh në rastin e të dhënave ekonomike të Shqipërisë. Në rastin kur të dhënat e disponueshme kanë frekuencë tjetër, bëhet transformimi i tyre në të dhëna tremujore. Gjithashtu, për të dhënat që karakterizohen nga sezonaliteti i lartë apo trend, aplikohen transformimet përkatëse për t'i pastruar nga sezonaliteti apo zhveshur nga trend-i. Kur mungojnë të dhënat për një tregues të caktuar ose seria është shumë e shkurtër, është përdorur seria e një nëntreguesi përafërues, i cili plotëson më mirë kriteret e kërkuara.

### 3.1. NDËRTIMI I KATEGORIVE DHE NËNTREGUESVE PËRBËRËS

Seksioni në vijim prezanton 8 kategoritë kryesore të hartës, si edhe nëntreguesit përbërës të secilës prej tyre. Në përzgjedhjen dhe ndërtimin e këtyre nëntreguesve janë marrë parasysh kriteret e prezantuara në seksionin e tretë, si edhe literatura e deritanishme e ndërtimit të HSF-së në vende të tjera. Një element i rëndësishëm që mbahet parasysh në diskutimin e secilit nëntregues është reflektimi në ecurinë e tij i periudhave të krizës apo të stresit financiar në Shqipëri, përkatësisht në vitin 1997, 2002 dhe së fundi në vitin 2008.

#### 1. *Ekonomia e brendshme*

Një ndër përcaktuesit kryesorë të stabilitetit financiar është ekonomia e brendshme, e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e situatës financiare të agjentëve ekonomikë, rrjedhimisht edhe të aftësisë së tyre paguese. Sipas Dahl et al. (2011), nëntreguesit e përfshirë në këtë kategori duhet të reflektojnë jo vetëm ecurinë ciklike të ekonomisë, por edhe përbërësit afatgjatë të saj. Duke pasur parasysh strukturën ekonomike të vendit tonë dhe lidhjet me sektorin financiar, janë përzgjedhur 5 nëntregues, vlerësimi me nota i të cilëve është bërë sipas "metodës standarde" :

1.1 **Hendeku i prodhimit.** Përfaqëson ecurinë e aktivitetit ekonomik dhe matet si diferencë midis PBB-së aktuale dhe prirjes historike të saj<sup>o</sup>, në raport ndaj PBB-së aktuale. Një vlerë e lartë negative e këtij nëntreguesi, pra thellimi i hendekut midis PBB-së aktuale dhe prirjes historike, sinjalizon ngadalësim të aktivitetit ekonomik, e për rrjedhojë, rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar.

<sup>o</sup> Prirja historike e PBB-së matet me filtrin Hodrick-Prescott.

- 1.2 **Madhësia e borxhit të jashtëm.** Ky nëntregues merr parasysh ekspozimin e ekonomisë shqiptare ndaj borxhit të jashtëm dhe matet si raport i stokut të borxhit të jashtëm ndaj PBB-së së vjetorizuar. Rritja e vlerave të këtij raporti nënkupton rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar, prandaj vlerësimi i serisë me nota është në kahun e drejtë.
- 1.3 **Nevojat për financim të pagesave të jashtme.** Ky nëntregues mat nëse një vend ka burime të mjaftueshme nga bilanci i llogarisë korrente për të paguar borxhin e jashtëm. Ai llogaritet si shuma e balancës së llogarisë korrente dhe totalit të flukseve të pagesave për borxhin e jashtëm (borxhi afatshkurtër<sup>7</sup> plus amortizimin brenda një viti i borxhit afatmesëm dhe atij afatgjatë). Nëse burimet e vendit janë të pamjaftueshme, nëntreguesi merr vlera pozitive, gjë që nënkupton ekspozim ndaj pagesave të borxhit të jashtëm. Sa më të larta të jenë këto vlera pozitive, aq më i lartë është ekspozimi ndaj pagesave të jashtme, duke sjellë rritje të rrezikut.
- 1.4 **Luhatshmëria e kursit të këmbimit.** Qëndrueshmëria e tregut valutor në Shqipëri është mjaft e rëndësishme për qëndrueshmërinë e sistemit financiar në vend, pasi një pjesë e konsiderueshme e financimit të bankave, bizneseve dhe individëve është në monedhë të huaj. Në ndërtimin e HSF-së, këto zhvillime janë marrë parasysh duke përfshirë si nëntregues ecurinë e REER, i cili matet si kursi i këmbimit të lekut ndaj monedhave të 5 partnerëve kryesorë tregtarë në terma realë. Seria kohore është mesatarizuar dhe është transformuar në terma të rritjes vjetore për të evidentuar momentet kryesore të mbi/nënçmimit të monedhës. Nënçmimi i monedhës vendase, pra rritja e vlerave të nëntreguesit, do të sillte rënie të aftësisë paguese të huamarrësve të bankave e për rrjedhojë, rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar.
- 1.5 **Norma e inflacionit.** Zhvillimet në normën e inflacionit kanë reflektuar momentet e stresit me të cilat është përballur ekonomia shqiptare dhe si i tillë, ky informacion i shërben ndërtimit të HSF-së. Seria kohore është llogaritur si ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumatorit. Rritja e tij konsiderohet se ka efekte negative në ekonomi, prandaj vlerësohet me një notë më të lartë rreziku.

## 2. Individët

Individët dhe bizneset janë agjentët kryesorë, të cilët monitorohen për qëllime të stabilitetit financiar në terma të aftësisë së tyre paguese, gjendjes financiare dhe përcaktimit të kërkesës për shërbimet e sektorit bankar. Për shkak se zhvillimet në tregun të ndryshëm të këtyre agjentëve mund të jenë të ndryshme, në ndërtimin e HSF-së ato janë paraqitur të ndarë dhe jo të agreguar në një kategori të vetme.

Kategoria "Individët" përfshin 6 nëntregues, të vlerësuar me nota sipas "metodës standarde":

<sup>7</sup> Në rastin tonë, meqë seria e borxhit afatshkurtër është shumë e shkurtër, duke filluar në vitin 2008, llogaritja e këtij nëntreguesi është përafshuar duke përdorur serinë e flukseve të pagesave për të gjithë borxhin e jashtëm.

- 2.1 **Pesha e huamarrjes së individëve.** Ky nëntregues ndërtohet si diferenca midis ecurisë aktuale dhe prirjes historike të raportit të kredisë për individë ndaj PBB-së së vjetorizuar. Në literaturë rekomandohet që të përdoret raporti i kredisë së individëve ndaj të ardhurave të disponueshme të tyre. Në rastin e Shqipërisë, vlerësimet për të ardhurat e disponueshme mungojnë, ndaj si përafres është përdorur treguesi i PBB-së. Nivele më të larta të kësaj difference sinjalizojnë rrezik në ulje, duke u vlerësuar me një notë më të ulët.
- 2.2 **Tregu i banesave.** Pasuria e paluajtshme vlerësohet si pjesa kryesore e pasurisë së individëve, ndërkohë që një pjesë e rëndësishme e huamarrjes së individëve përbëhet nga kredia për pasuri të paluajtshme. Një luhatje në çmimin e shtëpive reflektohet në gjendjen financiare të tyre. Nga ana tjetër, ky efekt pasqyrohet edhe në aktivitetin e bankave si financuese të huamarrjes së individëve në blerjen e shtëpive. Nëntreguesi është ndërtuar si seri diferencash midis vlerave aktuale të indeksit të çmimeve të banesave dhe prirjes afatgjatë të tij. Diferencat pozitive dhe në rritje janë konsideruar si përmirësim i gjendjes financiare të individëve e për rrjedhojë sinjalizojnë zbutje të rrezikut.
- 2.3 **Norma e regjistruar e papunësisë.** Edhe ky nëntregues është përfshirë për të vlerësuar situatën financiare të individëve, ku një normë më e lartë e papunësisë sinjalizon një rrezik në rritje dhe rrjedhimisht vlerësohet me një notë më të lartë.
- 2.4 **Cilësia e portofolit të kredisë për individët.** Cilësia e portofolit të kredisë për individët ka një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e sektorit bankar. Ajo ka ardhur duke u përkeqësuar pas krizës së vitit 2008, ndaj monitorimi i vazhdueshëm është i domosdoshëm për qëndrueshmërinë e stabilitetit financiar. Nëntreguesi i përfshirë është ndërtuar si raporti i kredive me probleme për individët dhe një rritje e vlerave të tij nënkupton rritje të rrezikut për sistemin financiar.
- 2.5 **Pritshmëritë e individëve.** Së fundmi, në ndërtimin e HSF-së kemi ndërthurur ecurinë aktuale të nëntreguesve me elementë që shikojnë nga e ardhmja. Në rastin e individëve, janë përfshirë pritshmëritë e tyre në lidhje me gjendjen financiare për tre muajt në vijim, të cilat identifikohen nëpërmjet vrojtimit të besimit të konsumatorëve. Një vlerë më e lartë e këtij nëntreguesi nënkupton një nivel rreziku më të ulët nga kategoria e individëve.
- 2.6 **Dërgesat e emigrantëve.** Në vlerësimin e situatës financiare të individëve, dërgesat e emigrantëve janë konsideruar një burim të ardhurash, i mundshëm për t'u përdorur edhe për shlyerjen e detyrimeve të tyre. Nëntreguesi i "dërgesave të emigrantëve" është matur si ndryshim vjetor i totalit tremujor të këtyre dërgesave. Rënia e vlerave të nëntreguesit, që nënkupton rënie të dërgesave të emigrantëve, ndikon negativisht në gjendjen financiare të individëve, e për rrjedhojë sjell një rritje të rrezikut nga kjo kategori.

### 3. Bizneset

Kjo kategori është ndërtuar me të njëjtat parime si në rastin e kategorisë së "individëve" dhe përbëhet nga 4 nëntregues, të vlerësuar gjithashtu sipas "metodës standarde":

- 3.1 **Pesha e huamarrjes së bizneseve.** Ky nëntregues është ndërtuar si seri e diferencave midis ecurisë aktuale dhe prirjes historike të raportit të kredisë për biznese ndaj PBB-së së vjetorizuar. Rritja e kësaj diference sinjalizon ulje të rrezikut nga sektori i bizneseve, duke u vlerësuar rrjedhimisht me një notë më të ulët.
- 3.2 **Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset.** Ky nëntregues është përfshirë në formën e raportit të kredive me probleme për biznese, ku rritja e këtij raporti nënkupton një rrezik më të lartë për sistemin financiar.
- 3.3 **Pritshmëritë e bizneseve.** Ashtu si në rastin e individëve, pritshmëritë e bizneseve lidhur me gjendjen financiare të tremujorit të ardhshëm janë përfshirë si një nëntregues me fokus drejt së ardhmes. Ai është përfshirë prej vrojtimit të besimit të biznesit, duke u llogaritur si një indeks mesatar i ponderuar i pritshmërive të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së përfshirë në këtë vrojtim. Rënia e vlerave të tij nënkupton rritje të nivelit të rrezikut.
- 3.4 **Indeksi i vëllimit të prodhimit.** Ky indeks është përfshirë si një tregues i ciklit të biznesit. Seria përmban indeksin e vëllimit të prodhimit dhe llogaritet si diferencë midis vlerës së indeksit të rregulluar sezonalisht dhe prirjes afatgjatë të tij. Diferenca të larta të vlerave të indeksit me prirjen historike të tij, sinjalizojnë zbutje të nivelit të rrezikut ndaj stabilitetit të sistemit financiar.

#### 4. Qeveria

Kategoria e qeverisë përbën agjentin e tretë të rëndësishëm në ekonomi së bashku me individët dhe bizneset. Ndikimi i zhvillimeve në kategorinë e qeverisë mbi stabilitetin financiar është trajtuar në terma të qëndrueshmërisë së borxhit të qeverisë, kostos së tij, deficitit dhe primit të rrezikut sovran, si dhe mbledhjes së të ardhurave. Sikurse në tre kategoritë e mëparshme, nëntreguesit e "qeverisë" janë vlerësuar me nota sipas "metodës standarde".

- 4.1 **Madhësia e borxhit të qeverisë.** Ky nëntregues është matur në formën e raportit të borxhit të qeverisë ndaj PBB-së. Një rritje e këtij raporti nënkupton një barrë më të madhe ndaj të ardhurave të vendit dhe rrjedhimisht edhe një rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar.
- 4.2 **Kosto e borxhit.** Rritja e kostos së borxhit të qeverisë nënkupton rritje të vështirësisë në shlyerjen e tij, duke pasur një ndikim të ndjeshëm në shpenzimet dhe rrjedhimisht edhe në borxhin e ardhshëm të saj. Si përfrues për këtë tregues është marrë raporti i shpenzimeve për interesa ndaj borxhit publik, ku rritja e këtij raporti nënkupton rritje të kostos së borxhit dhe rritje të rrezikut nga kategoria e qeverisë.
- 4.3 **Primi i rrezikut sovran.** Për të vlerësuar rrezikun sovran të Shqipërisë, është ndërtuar spread-i i normës 12-mujore të bonove të thesarit shqiptare ndaj atyre gjermane. Bonot e thesarit gjermane konsiderohen letra me vlerë pa rrezik, ndërkohë që bonot shqiptare janë një instrument i rëndësishëm investimi i likuiditetit në lekë për bankat shqiptare. Periudhat e stresit financiar janë të lidhura me një *spread* më të lartë për shkak se normat e interesit të bonove të thesarit shqiptare mund të rriten dhe normat e interesit mbi bonot pa rrezik mund të bien.

- 4.4 **Madhësia e deficitit buxhetor.** Një tjetër element i rëndësishëm i sjelljes së qeverisë është edhe madhësia e deficitit në raport ndaj PBB-së. Është e qartë që një nivel i lartë deficiti ndaj PBB-së sinjalizon një nivel më të lartë rreziku nga kategoria e qeverisë.
- 4.5 **Ecuria e të ardhurave tatimore.** Ky tregues synon të vlerësojë aftësinë e mbledhjes së të ardhurave nga qeveria përgjatë periudhës së analizuar dhe është matur nëpërmjet raportit të të ardhurave tatimore ndaj PBB-së. Një nivel i ulët i këtij raporti sinjalizon rrezik në rritje nga kategoria e qeverisë në stabilitetin financiar, ndaj vlerësohet me një notë më të lartë rreziku.

## 5. Mjedisi i jashtëm

Situata financiare e agjentëve të brendshëm ekonomikë dhe për pasojë aftësia paguese e tyre, mund të ndikohen në mënyra të ndryshme nga zhvillimet në mjedisin e jashtëm. Kriza e fundit globale tregoi se pavarësisht mospërfshirjes së drejtpërdrejtë të sistemit tonë financiar në krizën e vitit 2007, efektet negative u përçuan përmes kanaleve të ekonomisë reale, kryesisht atij tregtar dhe u përkthyen në rritje të kredive me probleme të sektorit bankar. Kjo evidentoi rëndësinë e monitorimit të goditjeve të jashtme, si një burim i mundshëm rreziku ndaj sektorit bankar në vend e për pasojë, ndaj stabilitetit financiar në tërësi. Në ndërtimin e HSF-së, zhvillimet në ekonominë e jashtme janë trajtuar si një kategori më vete, që përfshin 5 nëntregues:

- 5.1 **PBB-ja reale e partnerëve kryesorë tregtarë.** Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik të partnerëve kryesorë tregtarë mund të ndikojë negativisht rritjen ekonomike në vend, përmes rënies së kërkesës për eksporte. Si përfrues i kërkesës për eksportet tona është konsideruar mesatarja e peshuar e PBB-ve reale të 8 vendeve ku shkojnë rreth 70% e eksporteve<sup>8</sup>, sipas peshave përkatëse në totalin e eksporteve. Ky tregues ka natyrë parashikuese, pasi rënia e vlerave të tij sinjalizon rënie të kërkesës për eksportet tona. Kjo mund të sjellë ngadalësim të aktivitetit ekonomik në një moment të dytë dhe rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar, si rezultat i dobësisë së aftësisë paguese të agjentëve ekonomikë.
- 5.2 **Norma e ponderuar e papunësisë.** Kushtet në tregun e punës në vendet ku jetojnë shumica e emigrantëve shqiptarë lidhen ngushtë me dërgesat e tyre, që edhe pse në rënie, mbeten ende një burim i rëndësishëm fondesh për ekonominë e vendit. Meqë norma e papunësisë është një nga treguesit kryesorë të kushteve të tregut të punës, është ndërtuar nëntreguesi i normës mesatare të ponderuar të papunësisë së vendeve prej të cilave vijin rreth 90% e dërgesave të emigrantëve shqiptarë<sup>9</sup>. Rritja e kësaj norme ndikon negativisht remitancat dhe për pasojë vlerësohet me një notë më të lartë rreziku.

<sup>8</sup> Itali, Greqi, Gjermani, Kinë, Turqi, Spanjë, Maqedoni dhe Francë.

<sup>9</sup> Sipas të dhënave të Bankës Botërore (matrica e remitançave), rreth 90% e dërgesave të emigrantëve shqiptarë vijin nga: Greqia (46.2%); Italia (37.3%), SHBA-ja (6.4%) dhe Gjermania (1.2%).

- 5.3 **Ecuria e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare.** Ecuria e çmimeve të naftës ndikon aktivitetin ekonomik në terma të kostos së prodhimit dhe çmimeve të konsumit në vend. Në kushtet kur Shqipëria është importuese neto e naftës, vendi është i ekspozuar ndaj luhatjeve të çmimit të saj në tregjet ndërkombëtare. Për ndërtimin e këtij nëntreguesi është përdorur seria mujore e FMN-së për çmimet e naftës (*crude oil prices*) dhe është llogaritur norma tremujore me bazë vjetore, ku rritja e kësaj norme rrit rrezikun nga "mjedisi i jashtëm".
- 5.4 **OECD CLI (composite leading indicator).** Është një ndër indekset kryesore ndërkombëtare që sinjalizon pikat e kthimit në ciklin e biznesit, pra luhatjet e aktivitetit ekonomik rreth nivelit të prodhimit potencial afatgjatë<sup>10</sup>. Rënia e vlerave të indeksit sinjalizon kthesa negative në ciklin e biznesit, pra ngadalësim të aktivitetit ekonomik botëror dhe rritje të rrezikut nga "mjedisi i jashtëm". Meqë shpërndarja e vlerave në serinë e indeksit CLI është e gjerë, duke u luhatur ndjeshëm nga mesatarja, vlerësimi i serisë sipas "metodës standarde" nuk është i përshtatshëm, pasi luhatje të vogla në vlerat e serisë do të përktheheshin në luhatje të mëdha në vlerat e nëntreguesit të vlerësuar. Për këtë arsye, sikurse dhe tek Dahl et. al (2011), është përdorur një "metodë alternative" vlerësimi (shih Aneks 1).
- 5.5 **Norma mesatare 3-mujore e LIBOR dhe EURIBOR.** Tregjet financiare ndërkombëtare janë pjesë e rëndësishme e zhvillimeve të mjedisit të jashtëm. Për të kapur sinjalet që vijnë nga këto tregje është përfshirë dhe ecuria e normave të LIBOR dhe EURIBOR, si përfaqësuese të kostos së fondeve në tregjet ndërkombëtare. Sa më të larta këto norma, aq më e lartë është kjo kosto, dhe për pasojë më i lartë rreziku në sektorin bankar në vend. Nëntreguesi është ndërtuar si mesatare e thjeshtë e normave të LIBOR dhe EURIBOR 3-mujor dhe vlerësimi me nota rreziku është bërë me metodën standarde.

## 6. Kapitalizimi dhe përfitueshmëria e sektorit bankar

Stabiliteti financiar lidhet ngushtë me qëndrueshmërinë e bankave ndaj goditjeve të ndryshme. Në këtë kontekst, kapitali është tregues i aftësisë së bankës për të përthithur humbjet, ndërsa përfitueshmëria lidhet drejtpërdrejt me potencialin e saj për të zgjeruar këtë kapital. Pra, ekziston një ndërlidhje midis të dyjave meqë fitimet më të larta sjellin edhe rritje të kapitalit. Përfshirja e kësaj kategorie ka si qëllim të vlerësojë rrezikun e sektorit bankar të lidhur me kapitalin dhe përfitueshmërinë e bankave dhe ndërtohet nga 5 nëntregues:

- 6.1 **Diferenca midis "Normës së mjaftueshmërisë së kapitalit" dhe "Normës minimale të lejuar".** Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit<sup>11</sup> është një nga treguesit kryesorë të shëndetit financiar të një banke dhe të sistemit bankar në përgjithësi. Kriza e fundit financiare e theksoi më tej rëndësinë

<sup>10</sup> Ky tregues përfshin një gamë të gjerë nëntreguesish afatshkurtër për vendet e OECD-së si: çmimet e lëndëve të para, të dhënat e tregut të punës, agregatët monetarë, variabla financiarë etj. Është përdorur në ndërtimin e hartave të stabilitetit nga FMN-ja, Banka e Norvegjisë, Banka e Zelandës së Re etj.

<sup>11</sup> Llogaritet si raport i "Kapitalit rregullator" ndaj "Aktiveve të ponderuara në rrezik".



- e mbajtjes së tij mbi një nivel të konsideruar si "të sigurtë"<sup>12</sup> dhe sa më e lartë të jetë diferenca midis normës faktike të kapitalit dhe minimumit të lejuar, aq më i mbrojtur është sektori bankar ndaj goditjeve. Një diferencë e ulët nënkupton një mbulim më të vogël dhe për pasojë rrezik më të lartë.
- 6.2 **Raporti i kredive me probleme**<sup>13</sup>. Ky është treguesi kryesor i cilësisë së portofolit të bankave. Rritja e këtij raporti nënkupton gërryerje të kapitalit të bankave për shkak të rritjes së provigjioneve, duke sinjalizuar rritje të rrezikut nga sektori bankar.
- 6.3 **Raporti i kapitalit aksioner ndaj totalit të aktiveve**. Ky tregues mat se ç'pjesë e aktiveve është financuar me kapitalin e vetë aksionerëve. Meqë kapitali është barriera e parë ndaj humbjeve të bankës, një nivel i lartë i këtij raporti nënkupton një kapacitet më të mirë përthithës ndaj humbjeve të mundshme, pra rrezik më të ulët nga sektori bankar.
- 6.4 **Të ardhurat neto nga interesat ndaj totalit të aktiveve**. Të ardhurat neto nga interesat (të ardhurat nga interesat – shpenzimet për interesat), përbëjnë pjesën kryesore të të ardhurave të bankave në Shqipëri. Sa më e lartë të jetë pesha e tyre ndaj totalit të aktiveve, aq më të larta janë fitimet e bankës dhe e anasjella, prandaj rënia e vlerës së këtij treguesi nënkupton rritje të rrezikut nga sektori bankar.
- 6.5 **Rezultati neto para taksave ndaj totalit të aktiveve**. Një rezultat financiar pozitiv është kusht themelor për forcimin e kapitalizimit të bankave (Dahl et. al, 2011). Rezultati neto i bankës (fitimi/humbja) varet nga të ardhurat nga interesat dhe humbjet nga kreditë me probleme, të cilat i kemi përfshirë në nëntreguesit e mësipërm, si dhe të ardhurat/shpenzimet operative (të ardhura nga komisionet, shpenzime personeli etj). Në ndërtimin e këtij treguesi është përdorur "rezultati neto para taksave" në raport me totalin e aktiveve të bankave, me qëllim që të evitohen luhatjet e fitimit/humbjes si rezultat i ndryshimeve në sistemin e taksimit<sup>14</sup>. Rënia e vlerës së këtij treguesi do të thotë rënie e fitimit në raport me aktivet dhe rritje të rrezikut për sektorin bankar.

## 7. Likuiditeti dhe financimi i sektorit bankar

Kjo kategori ka si qëllim vlerësimin e nivelit të rrezikut ndaj stabilitetit financiar, për shkak të strukturës së fondeve dhe likuiditetit të sektorit bankar. Nëse kjo strukturë është e dobët, atëherë sektori do të jetë më pak i aftë të përballojë goditjet e mundshme (Dahl et. al, 2011). Kategoria e "likuiditetit dhe financimit" përfshin 4 nëntregues të vlerësuar sipas metodës standarde:

- 7.1 **Raporti depozita/kredi**. Ky raport vlerëson mbulimin e kredisë me depozita si një ndër burimet kryesore të financimit të bankave. Një vlerë e lartë e tij nënkupton një mbrojtje më të mirë të bankave ndaj goditjeve në terma të kreditimit dhe njëkohësisht një mbulim më të mirë me financim, pra një nivel më të ulët rreziku.

<sup>12</sup> Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë norma minimale e lejuar është 12%.

<sup>13</sup> Llogaritet si raporti i "Huave me probleme (bruto)" ndaj "Tepicës së kredisë".

<sup>14</sup> Seria kohore e "rezultatit neto para taksave/totali i aktiveve" është e pastruar nga sezonaliteti.

- 7.2 **Norma e rritjes së depozitave të individëve.** Depozitat e individëve janë burimi kryesor i fondeve të bankave, por njëkohësisht burimi më i ndjeshëm ndaj tronditjeve në sistemin financiar. Për këtë arsye, norma e rritjes së depozitave është një tregues i rëndësishëm i ecurisë së likuiditetit dhe besueshmërisë në sistemin bankar në vend, ku vlerat e larta reflektojnë një besim në rritje dhe nivele të larta likuiditeti. Kriza financiare botërore 2007-2008, pasojat e së cilës u ndjenë në sektorin bankar shqiptar, kryesisht në periudhën 2009-2010, u shoqërua edhe me tërheqje të një pjese të depozitave dhe me një ritëm të ulët të hapjes së depozitave të reja. Për pasojë, treguesi i rritjes së depozitave të individëve pësoi rënie të shpejtë, duke shënuar edhe periudha me vlera negative.
- 7.3 **Financimi nga jorezidentët.** Jorezidentët përbëjnë një tjetër burim financimi për bankat, gjithashtu mjaft të ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në sektorin bankar. Një nivel i lartë financimi nga jorezidentët rrit rrezikun në sektorin bankar, pasi në rast krize jorezidentët mund të tërheqin burimet e tyre jashtë vendit. Nëntreguesi është ndërtuar si raport i financimit nga jorezidentët ndaj financimit total të sektorit bankar, ku një rritje e vlerës së tij vlerësohet me një notë më të lartë rreziku.
- 7.4 **Diferenca midis "aktive afatshkurtra" dhe "pasive afatshkurtra" deri në 3 muaj.** Me qëllim vlerësimit të rrezikut të financimit afatshkurtër, është përfshirë nëntreguesi i likuiditetit të matur si diferencë midis "aktiveve afatshkurtra" dhe "pasiveve afatshkurtra" deri në 3 muaj<sup>15</sup>. Meqë "pasivet afatshkurtra" i kanë tejkaluar gjatë gjithë kohës "aktivet afatshkurtra", vlerat e kësaj serie janë negative, por sa më e thellë të jetë kjo diferencë aq më pak të mbuluara janë pasivet afatshkurtra me mjete likuide, pra aq më vulnerabel është sektori bankar në aspektin e financimit.

## 8. Struktura e sektorit bankar

Struktura e sektorit bankar në aspekte të shpërndarjes së aktiveve brenda sektorit, nivelit të kapitalizimit, nivelit të kredihënies ndaj sektorit të biznesit apo diversifikimit të burimeve të financimit, mund të bëhen burim rreziku ndaj goditjeve të mundshme sistematike. Kategoria e strukturës së sektorit bankar bazohet në 5 nëntregues:

- 8.1 **Pesha e aktiveve të 2 bankave më të mëdha në vend ndaj totalit të aktiveve.** Pesha e bankës më të madhe në vend në totalin e aktiveve të sektorit, tregon nëse ajo e dominon ose jo sektorin bankar në vend. Sa më e madhe të jetë kjo peshë, çka nënkupton edhe një peshë të vogël të bankave të tjera të sektorit, aq më i varur është sektori ndaj performancës së bankës më të madhe. Meqë në sektorin bankar shqiptar përgjithësisht janë evidentuar dy banka kryesore, Banka Raiffeisen (Banka e Kursimeve para privatizimit) dhe Banka Kombëtare Tregtare, nëntreguesi është ndërtuar si raport (në përqindje) i totalit të aktiveve të këtyre dy bankave

<sup>15</sup> Raporti "Aktive likuide/Detyrime afatshkurtra" do të përbënte një tregues më të saktë për likuiditetin, por meqë përdorimi i këtij treguesi ka filluar në fundin e vitit 2009, seria kohore është shumë e shkurtër për t'u përdorur në HSF. Për këtë arsye, kemi përdorur diferencën e aktiveve afatshkurtra dhe pasiveve afatshkurtra deri në 3 muaj, si përafrues për ecurinë e likuiditetin në sektorin bankar shqiptar.

ndaj totalit të aktiveve të sektorit. Për të konvertuar vlerat e serisë në nota rreziku është përdorur "metoda alternative" me vendosje kufijsh a priori (një kufi i poshtëm prej 20% dhe një kufi i sipërm prej 70%). Sa herë që pesha e dy bankave të mëdha bie nën 20% të sektorit bankar, rreziku konsiderohet minimal dhe nëntreguesi merr automatikisht vlerën e rrezikut 0; sa herë që kjo peshë tejkalon 70% të sektorit, rreziku konsiderohet maksimal dhe nëntreguesi merr vlerën 10. Intervali midis këtyre kufijve ndahet në 9 nënintervale me madhësi të barabartë dhe bëhet vlerësimi i tyre me nota rreziku nga 1 në 9 (shih Aneks 1).

**8.2 Norma e huadhënies ndaj sektorit të bizneseve.** Kredia për bizneset është një produkt më heterogjen se kredia për individët dhe ka peshë më të lartë në portofolin e kredive të bankave, ndaj në rast vështirësie të sektorit bankar, menaxhimi i kësaj pjese është më i vështirë. Ky nëntregues synon të kapë rrezikun që vjen, si pasojë e shpërndarjes së kredidhënies për biznesin në sektorin bankar në vend. Sa më e përqendruar (në një numër të vogël bankash) të jetë kjo kredidhënie, aq më i rrezikuar është sektori bankar. Ndërtimi i treguesit bazohet në kredinë e dhënë ndaj bizneseve nga 5 bankat më të mëdha në vend dhe përcaktohet si raport i kredisë për bizneset të dhënë nga banka e dytë, e tretë, e katërt dhe e pestë, ndaj kredisë për bizneset të dhënë nga banka më e madhe në vend. Sa më e lartë të jetë kjo normë, aq më e shpërndarë është kredidhënia e sektorit bankar ndaj biznesit, e për rrjedhojë rreziku është më i ulët (Shih Aneks 1). Vlerësimi me nota është bërë duke vendosur fillimisht a priori dy kufij: nën 100% dhe mbi 250%. Vlera në kufi 100% përfaqëson situatën, ku huadhënia e bankës më të madhe ndaj sektorit të biznesit është sa huadhënia totale e 4 bankave të tjera më të mëdha ndaj të njëjtit treg, gjë që tregon një përqendrim të lartë të kredidhënies në bankën kryesore dhe për pasojë një rrezik të lartë. Vlera në kufi 250% përfaqëson situatën, ku huadhënia nga banka më e madhe është 40% e huadhënies totale të 4 bankave të tjera, pra shpërndarja është e lartë dhe për rrjedhojë rreziku është i ulët. Për të gjitha vlerat nën kufirin e normës 100%, treguesi merr automatikisht vlerësimin 10 dhe për të gjitha vlerat mbi kufirin 250%, nëntreguesi merr automatikisht vlerësimin 0. Intervali midis këtyre kufijve ndahet në 9 nënintervale të barabarta dhe vlerësimi bëhet në kahun e anasjellë (Shih Aneks 1).


Tre nëntreguesit e fundit të kësaj kategorie vlerësojnë shpërndarjen e strukturës së kredisë, financimit dhe kapitalit rregullator brenda sektorit bankar. Dy të parët vlerësojnë ekspozimin ndaj huamarrësve dhe burimeve të financimit, ndërsa treguesi i fundit vlerëson devijimet ndaj normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Sipas Dahl et. al (2011), bankat me karakteristika të ngjashme mund të ndikohen në të njëjtën mënyrë nga një goditje në ekonomi. Një sektor bankar që përbëhet nga një numër i lartë bankash me ekspozim të njëjtë, ndaj kategorive të ndryshme huamarrëse apo me strukturë të njëjtë të burimeve të financimit, mund të rezultojë më i ndjeshëm ndaj goditjeve. Për të kapur këto ekspozime, janë ndërtuar 2 nëntregues: i pari analizon diferencat në strukturën e huadhënies dhe i dyti analizon diferencat në strukturën e financimit të veprimtarisë, bazuar në llogaritjen e variancës midis ekspozimit të bankave të veçanta dhe ekspozimit mesatar të sektorit bankar shqiptar. Vlerësimi me nota për të tre këta nëntregues është bërë sipas "metodës standarde":

- 8.3 **Devijimi i strukturës së portofolit të kredisë së bankave ndaj strukturës së sektorit.** Për ndërtimin e këtij nëntreguesi, fillimisht portofoli i kredisë totale të bankave është ndarë në tre nëngrupe kryesore: (1) kredia ndaj sektorit privat, (2) kredia ndaj sektorit publik, (3) kredia për individët, të shprehura si pështa në përqindje ndaj totalit të sektorit bankar. Më pas është ndërtuar seria e devijimeve midis strukturës së kredisë së secilës bankë dhe atij të tregut. Së fundi, bëhet llogaritja e variancës së devijimeve duke u bazuar në pështat e huadhënies së secilës bankë, kundrejt totalit të huadhënies së sektorit bankar. Sa më e lartë të jetë kjo variancë, aq më i diversifikuar është sektori bankar dhe rrjedhimisht aq më elastik ndaj goditjeve.
- 8.4 **Devijimi i strukturës së fondeve të bankave ndaj strukturës së sektorit.** Parimisht, ndërtimi i këtij nëntreguesi është i ngjashëm me nëntreguesin e strukturës së kredisë. Për çdo bankë të veçantë dhe në nivel sektori, nga burimet e financimit fillimisht përjashtohen fondet e veta dhe pjesa tjetër grupohet në 6 nëngrupe: 1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare; 2. Llogari rrjedhëse (administratë publike + sektor privat); 3. Depozita pa afat (administratë publike + sektor privat); 4. Depozita me afat (administratë publike + sektor privat); 5. Të tjera (administratë publike + sektor privat); 6. Letra me vlerë + detyrime të tjera. Më pas ndërtohen seritë e diferencave të strukturës së fondeve të shprehura në përqindje midis secilës bankë dhe strukturës së fondeve të totalit të sektorit bankar. Në fund llogaritet varianca e diferencave, duke përdorur pështat e çdo banke në totalin e fondeve të sektorit bankar. Sa më e lartë të jetë kjo variancë, aq më i diversifikuar është sektori bankar dhe rrjedhimisht më elastik ndaj goditjeve.
- 8.5 **Devijimi ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit bankar.** Ndërtimi i këtij treguesi bazohet në normën mesatare të kapitalizimit të sektorit bankar në Shqipëri. Edhe pse të gjitha bankat ruajnë një normë kapitalizimi mbi normën e lejueshme prej 12%, ka banka që qëndrojnë pranë këtij minimumi, çka do të thotë se kapitalizimi i tyre mund të jetë nën normën mesatare të kapitalizimit të sektorit. Për këtë qëllim, ndërtohet varianca e ndryshimit midis normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar, vetëm për ato banka që ndodhen poshtë këtij niveli mesatar. Sa më e lartë të jetë kjo variancë, aq më i ndjeshëm ndaj goditjeve konsiderohet sektori bankar. Me qëllim marrjen parasysh të peshës së bankave të mëdha në këtë nëntregues, varianca është ndërtuar e ponderuar me peshën e secilës bankë në totalin e aktiveve.

### 3.2 PERFORMANCA E TREGUESVE TË MESATARIZUAR TË ÇDO KATEGORIE

Seritë e nëntreguesve të përshkruar më lart mesatarizohen me mesatare të thjeshtë për të ndërtuar treguesit përkatës të çdo kategorie të hartës. Në vazhdim, paraqiten grafikisht të 8 treguesit e mesatarizuar për çdo kategori dhe analizohet performanca e tyre në reflektimin e momenteve të krizave.

Figurë 2. Treguesit e mesatarizuar për çdo kategori të HSF-së



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorëve.

Treguesit e mesatarizuar për kategoritë e "Ekonomisë së brendshme" dhe "Mjedisit të jashtëm" reflektojnë një nivel të ulët rreziku në periudhën para krizës financiare 2007-2008, me vlera nën nivelin mesatar. Në periudhën 2007T4-2008T3, treguesi i "Mjedisit të jashtëm" merr vlera rreziku mbi mesataren, kryesisht si rezultat i rritjes së presioneve në tregjet financiare. Vlerat e tij gjithashtu tentojnë të rriten gjatë vitit 2011, si pasojë e dy tronditjeve të tjera në mjedisin e jashtëm: kriza greke dhe kriza e borxhit në Eurozonë, ku

kontributin kryesor e kanë dhënë rënia e PBB-së së partnerëve tanë tregtarë dhe rritja e papunësisë në vendet fqinje (Itali dhe Greqi). Kategoria "Ekonomia e brendshme" duket se e pasqyron krizën financiare pas 2008T4, ku vlerësimi i rrezikut luhetet në vlerat 6-8. Kontributi kryesor në këtë vlerësim ka ardhur nga hendeku i prodhimit dhe madhësia e borxhit të jashtëm.

Treguesit e mesatarizuar të kategorive "Individët" dhe "Bizneset", gjithashtu rezultojnë me nivel rreziku nën mesatar para krizës financiare. Rreziku nga kategoria "Individët" ka filluar të rritet gjatë periudhës 2008-2010, kryesisht për shkak të rritjes së normës së papunësisë, rënies së cilësisë së portofolit të kredisë, rënies së pritshmërive dhe dërgesave të emigrantëve. Pas 2012T2, rreziku nga kjo kategori shënon një kapërcim të ri mbi mesataren dhe ka vazhduar të qëndrojë mbi këtë nivel, kryesisht për shkak të rënies së ndjeshme të cilësisë së portofolit të individëve dhe ngadalësimit të kreditimit për këtë sektor. Kategoria "Bizneset" i reflekton pasojat e krizës pas 2008T4, periudhë që përkon me rënien e ritmit të kreditimit për bizneset nën mesataren afatgjatë, si edhe rënie të indeksit të vëllimit të prodhimit. Pas 2012T2, niveli i rrezikut i përcjellë nga kjo kategori ka reflektuar një rritje të ndjeshme për shkak të ngadalësimit të kreditimit, përkeqësimit të cilësisë së kredisë dhe të pritshmërive të bizneseve.

Për kategorinë e "Qeverisë", rreziku ka qenë mbi nivelin mesatar deri në 2004T4, si rezultat i madhësisë së deficitit buxhetor dhe kostos së borxhit në këtë periudhë, por ka ardhur duke u zbutur gjatë periudhës së konsolidimit fiskal 2005-2006. Kjo tendencë ka vijuar deri në periudhën para krizës financiare, ku rreziku nga kjo kategori vlerësohet i ulët, me vlera të treguesit të mesatarizuar rreth 1 dhe 2. Në vitin 2009, treguesi është rritur pak mbi nivelin mesatar, kryesisht prej kontributit të madhësisë së borxhit të qeverisë dhe primit të rrezikut sovran, por duke u pasuar nga një periudhë zbutjeje. Duke filluar që prej 2012T2, ecuria e treguesit të mesatarizuar të kësaj kategorie sinjalizon rritje të rrezikut, si rezultat i zgjerimit të ndjeshëm të borxhit dhe deficitit buxhetor dhe ecurisë së dobët të të ardhurave tatimore.

Treguesi i mesatarizuar i "Kapitalizimit dhe përfitueshmërisë" së sektorit bankar paraqet vlera të ulëta rreziku si para krizës financiare (periudha 2006-2007) dhe gjatë saj (2007-2008), çka reflekton situatën e mirë të kapitalizimit dhe përfitueshmërisë në këtë periudhë dhe mospërfshirjen e bankave tona në investime toksike. Rreziku lidhur me këtë kategori është rritur mbi mesataren që nga 2011T1 dhe ka vazhduar të qëndrojë mbi këtë nivel, kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të kredive me probleme dhe efektit gërryes të tyre mbi kapitalizimin dhe përfitueshmërinë e bankave. Nga ana tjetër, treguesi i mesatarizuar i kategorisë "Likuiditeti dhe financimi" shfaq një reagim të fortë në momentet e zhvillimit të krizës financiare në periudhën 2007-2008, me nota rreziku në rritje dhe mbi nivelin mesatar. Ai arrin vlerat maksimale gjatë periudhës 2008T4-2009T4, kur pasojat e krizës u ndjenë në sektorin bankar shqiptar kryesisht në aspektin e rritjes së pasigurisë së publikut, gjë që u shoqërua me rrjedhje të depozitave jashtë sistemit financiar dhe rënie të ndjeshme të likuiditetit. Pas kësaj periudhe, vlerësimi i rrezikut ka ardhur duke u zbutur, si rezultat i rikthimit të depozitave në sistem dhe përmirësimit të situatës

së likuiditetit gjatë vitit 2010. Gjithsesi, niveli i rrezikut nga kjo kategori vijon të mbetet ndjeshëm mbi nivelin mesatar dhe me tendencë rritëse, ndikuar kryesisht nga rënia e vazhdueshme e ritmit të depozitimit të individëve në sistem dhe tendenca rënëse e raportit depozita/kredi.

Në ndryshim nga dy kategoritë e lartpërmendura të sektorit bankar, niveli i rrezikut nga kategoria e "Strukturës së sektorit bankar" vlerësohet si mesatar ose pak mbi mesatar në periudhën para krizës financiare (para 2007T4), ndërsa gjatë krizës dhe më pas, vlerësimi për rrezikun bie nën nivelin mesatar. Pikërisht në këtë periudhë, bankat kanë diversifikuar strukturën e burimeve të financimit të tyre si reagim ndaj krizës financiare, gjë që ka sjellë zbutje të rrezikut nga kjo kategori. Gjatë dy viteve të fundit, vlerësimi i rrezikut nga kjo kategori ka ardhur duke u zbutur më tej, kryesisht si rezultat i rënies së vazhdueshme të peshës së bankës më të madhe në vend (Bankës Raiffeisen), duke e ulur peshën e përbashkët të dy bankave dominuese.

#### 4. PARAQITJA GRAFIKE E HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR

Në figurën 3 (A dhe B), paraqiten të gjithë kategoritë e nëntreguesve, të kombinuara në trajtën e një diagrame (hartë e stabilitetit financiar) në disa periudha kyçe, si momentet para, gjatë dhe pas një tronditjeje financiare. Paraqitja e kësaj diagrame në momente të ndryshme kohe jep vizualisht idenë se si zhvendosen rreziqet ndaj stabilitetit financiar në vend nga sektorë/agjentë të ndryshëm të ekonomisë.


Konkretisht, në figurën 3(A) paraqitet harta e stabilitetit financiar në disa momente kyçe, si para shpërthimit të krizës financiare (periudhat 2006T4 dhe 2007T4), gjatë zhvillimit të krizës në tregjet ndërkombëtare (2007-2008) dhe në periudhën e evidentimit të pasojave të krizës në ekonominë shqiptare (2008-2009). Kështu, para krizës harta është kryesisht e mbledhur rreth qendrës, çka tregon që niveli i rrezikut nga të gjithë kategoritë e treguesve të përfshirë ka qenë përgjithësisht i ulët. Shpërthimi i krizës financiare në vitin 2007 duket se fillimisht nuk ka dhënë ndonjë efekt të dukshëm në ekonominë e brendshme dhe në sektorin bankar, pasi në këtë periudhë vlerat e rrezikut për kategoritë e treguesve që lidhen me to, kanë rezultuar nën nivelin mesatar. Nga ana tjetër, vlerat e rrezikut nga kategoria e "ekonomisë së jashtme" janë rritur ndjeshëm në momentet e para të krizës (2007T4), duke reflektuar tronditjet në tregjet financiare përmes rritjes së normave kryesore të interesit (LIBOR, EURIBOR) dhe rritjes së shpejtë të çmimit të naftës. Me përshkallëzimin e mëtejshëm të krizës gjatë periudhës 2008-2009, harta zgjerohet duke iu larguar qendrës, por është më e zhvendosur drejt treguesve jashtë sektorit bankar. Kjo tregon se në këtë periudhë rreziqet kryesore rrjedhin nga ekonomia reale dhe agjentët ekonomikë: individët, bizneset dhe qeveria.

Figura 3(B) paraqet HSF-në në disa momente të tjera si: gjatë krizës greke (2010T1-2010T4), që u pasua me krizën e borxhit sovran në Eurozonë (2011T2) dhe në dy vitet e fundit (2013-2014). Siç vihet re në figurë, në



periudhën 2010-2011, niveli i rrezikut nga zhvillimet e jashtme është rritur mbi nivelin mesatar, ndërkohë që rreziqet nga faktorë të brendshëm kanë ardhur duke u zhvendosur nga ekonomia reale drejt sektorit bankar, veçanërisht në treguesit e "likuiditetit dhe fondeve" dhe "kapitalizimit dhe përfitueshmërisë". Figura gjithashtu paraqet HSF-në në dy vitet e fundit (2013-2014), ku lëvizja e diagramës në kohë tregon se rreziqet që lidhen me agjentët ekonomikë janë në rritje, veçanërisht për individët dhe bizneset. Kjo reflekton rritjen e rreziqeve nga këta sektorë, si rezultat i tkurrjes së kredisë dhe përkeqësimit të cilësisë së saj, rënies së indeksit të vëllimit të prodhimit tek bizneset dhe rritjes së papunësisë. Në sektorin bankar, niveli i rrezikut të lidhur me "strukturën e sektorit" ka ardhur duke u ulur nën nivelin mesatar gjatë të tre periudhave të marra në shqyrtim, kryesisht si rezultat i zbutjes së përqendrimit brenda sektorit dhe rritjes së diversifikimit në strukturën e financimit. Ndërkohë, rreziqet lidhur me "likuiditetin dhe financimin"/"kapitalizmin dhe përfitueshmërinë" kanë qenë të larta gjatë vitit të kaluar, duke reflektuar nivelin e lartë të kredive me probleme dhe rënien e fitimeve në këtë periudhë. Gjithsesi, duket se niveli i rrezikut nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria" është moderuar gjatë vitit 2014, kryesisht si rezultat i përmirësimit të fitimeve të bankave.

Figurë 3(A)(B). Harta e Stabilitetit Financiar në periudha të ndryshme



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorëve.

## 5. PËRFUNDIME

Harta e Stabilitetit Financiar e ndërtuar si një model "rrjetë", është në vetvete një instrument teknik që përmbledh në një paraqitje të vetme grafike rreziqet, që vijjnë në një moment të caktuar nga faktorë brenda dhe jashtë sektorit bankar. Harta e ndërtuar për rastin e Shqipërisë duket se performon përgjithësisht mirë, duke pasqyruar efektet e tronditjeve të jashtme dhe të brendshme në stabilitetin financiar në vend. Performanca e modelit varet shumë nga lloji i nëntreguesve të përfshirë në ndërtimin e çdo kategorie, gjë që lë gjithmonë vend për diskutim. Gjithashtu, disa nga kategoritë reagojnë më shpejt në sinjalizimin e rreziqeve ndaj stabilitetit, gjë që lidhet ngushtë edhe me momentin e raportimit

të të dhënave të përfshira në ndërtimin e nëntreguesve të secilës kategori, një pjesë e të cilave kanë vonesa kohore disa mujore.

Duke pasur parasysh këto kufizime, HSF-ja nuk duhet të shihet si një instrument që gjykon mbi qëndrueshmërinë e sistemit financiar, por si një mjet praktik që ankoron diskutimin dhe fokuson vëmendjen e lexuesit rreth rreziqeve aktuale. Vlerësimi i stabilitetit financiar kërkon vlerësimin e një sërë faktorëve që nuk mund të përmbliidhen në një model të vetëm. Për këtë arsye, është e rëndësishme të mbahet parasysh se rezultatet e HSF-së duhet të përdoren së bashku me rezultatet e analizave dhe instrumentëve të tjerë të përdorura rregullisht nga Banka e Shqipërisë për të gjykuar mbi stabilitetin financiar në vend.

Meqë mjedisi financiar është mjaft dinamik dhe çdo krizë ka natyrë të veçantë, është e rëndësishme që harta të përditësohet rregullisht dhe të përmirësohet duke iu përshtatur zhvillimeve ekonomike të brendshme dhe të jashtme, për të kapur më mirë dhe në kohë rreziqet ndaj sistemit tonë financiar. Kjo mund të kërkojë përfshirjen e treguesve të rinj apo përpunim të mëtejshëm të treguesve ekzistues.

## REFERENCA

*Bedford, Paul and Chris Bloor (2009): "A Cobweb Model of Financial Stability in New Zealand", Reserve Bank of New Zealand Discussion Paper Series No. 11*

*Dattels, Peter, McCaughrin Rebecca, Ken Miyajima and Jaume Puig (2010): "Can You Map Global Financial Stability?", IMF Working Paper No. 145*

*Geir Arne Dahl, (2011): "A cobweb model of financial stability in Norway", Norges Bank, Staff Memo No 15/2011*

*Kota Vasilika dhe Saqe Arisa "A Financial Systemic Stress Index for Albania", presented at "The 5th Eastern European Economic Research Workshop" (Tirana, 10-11 November 2011)".*

*Kota Vasilika and Dushku Elona, (2010) "Macroeconometric Model of Albania-A follow up", Discussion paper, No. 4 (34), Bank of Albania.*

## SFIDAT E ZBATIMIT TË BAZEL II

Lindita Vrioni

Departamenti i Kërkimeve

### ABSTRAKT

Marrëveshja e Bazel II, synon që kapitali rregullator i bankave të jetë në harmoni me rreziqet me të cilat përballen bankat, duke inkurajuar praktikat e menaxhimit të rrezikut sistemik, veçanërisht në lidhje me rrezikun e kredisë. Rregullorja e re e Bankës së Shqipërisë, "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", që hyri në fuqi më 31 dhjetor 2014, detyron bankat të përdorin metodën standarde (e thjeshtë) për llogaritjen e rrezikut të kredisë. Ky material, ofron një analizë të dy opsioneve të zbatimit (SA dhe IRB), nëpërmjet diskutimit të kostove dhe përfitimeve, si dhe trajton sfidat që mund të përballë sistemi bankar gjatë zbatimit të Bazel II. Përderisa metoda standarde sjell një ndikim të vogël në drejtim të menaxhimit të rrezikut të kredisë dhe nga ana tjetër, ekzistenca e disa pengesave e bën zbatimin e metodës modelore (IRB) të vështirë, në këtë material propozohet një rrugë alternative për zbatimin e standardit të kapitalit, në kontekstin e sistemit bankar shqiptar (duke përdorur të dhënat e Regjistrimit të Kredive)<sup>1</sup>.

### HYRJA

Marrëveshja e Bazel II, është tashmë një ligj ndërkombëtar për kapitalin rregullator dhe jo thjesht një standard ndërkombëtar. Rreth 140 vende zbatojnë kërkesat e tij, për shkak se Bazel II në BE po zbatohet në formën e Direktivës së Kërkesës për Kapital, që u miratua nga Komisioni i BE-së në korrik të vitit 2004 dhe solli zbatimin e kërkesave të Bazel II në mënyrën e mbikëqyrjes së konsoliduar<sup>2</sup>. Direktiva Evropiane zbatohet nga të gjitha institucionet e kreditit dhe firmat investuese, pavarësisht madhësisë së tyre, duke i inkurajuar ato në përmirësimin e sistemeve të tyre të brendshme, për të pasur një menaxhim më të ndjeshëm ndaj rrezikut të aktiviteteve të tyre në të ardhmen<sup>3</sup>.

Të gjitha vendet, sidomos ato të zhvilluarat, e kanë konsideruar zbatimin e Bazel II, si një mbështetje për përmirësimin e cilësisë së kapitalit të bankave. Për të njëjtin qëllim, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren e re të mjaftueshmërisë së kapitalit, që hyri në fuqi më 31 dhjetor 2014.

<sup>1</sup> Ky material është përgjegjësi e autores, këndvështrimi i së cilës nuk reflekton atë të Bankës së Shqipërisë.

<sup>2</sup> Për më tepër detaje, konsultohu me Ayadi & Resti (2004) dhe BCBS (2006).

<sup>3</sup> Për tekstin e plotë të direktivës shiko faqen e internetit të Komisionit Evropian: [http://europa.eu.int/comm/internal\\_market/bank/regcapital/index\\_en.htm#capitalrequire](http://europa.eu.int/comm/internal_market/bank/regcapital/index_en.htm#capitalrequire)

Përderisa sistemi financiar shqiptar mbizotërohet nga sistemi bankar, ekonomia mbështetet kryesisht në financimin e bankave. Për këtë arsye, rëndësia e sistemit bankar për stabilitetin financiar dhe ekonomik është jetike. Duke pasur parasysh faktin se thelbi i aktivitetit bankar është të marrë dhe të menaxhojë rreziqet, Bazeli II ndihmon në përshtatjen sa më të mirë të kapitalit rregullator të bankave me rreziqet aktuale me të cilat ballafaqohen.

Shumë studime akademike empirike, si dhe studime të impaktit të Bazeli II nga BIS, të cilat mbështesin disa nga përfitimet teorike të zbatimit të Bazeli II, shtrojnë si pyetje kryesore nëse këto përfitime do të rezultojnë si të tilla edhe në praktikë për sistemin bankar shqiptar.

Ky punim, ndërsa mbështet krijimin e një kuadri të kapitalit të bazuar më ndjeshëm ndaj rrezikut, trajton dhe disa shqetësime në lidhje me metodën e zgjedhur nga rregullatori mbikëqyrës, për zbatimin e kërkesave për kapital, për rrezikun e kredisë, pra metodën standarde. Është për t'u konsideruar nëse kjo metodë do t'i japë bankave stimuj të mjaftueshëm për të përmirësuar vlerësimin dhe menaxhimin e teknikave të rrezikut dhe nëse do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi rregullator koherent dhe në konvergjencë me sistemin bankar evropian. Gjithashtu, duhet të kontrollojmë nëse para-kushtet për zbatimin e metodës së bazuar në vlerësimin e brendshëm (IRB) janë të zbatueshme në rastin tonë. Në dukje, të dyja metodat kanë problemet e veta. Kështu, duke peshuar atë që ato ofrojnë në tregun shqiptar, propozojmë një alternativë për të ndihmuar zbatimin e Bazeli II në Shqipëri. Një zbatim i tillë i Bazeli II do të jetë i mundur nëse përdoret informacioni i mbledhur në Regjistrin e Kredive. Ky dokument përqendrohet vetëm te rreziku i kredisë bazuar në thënien e Roger Ferguson<sup>4</sup> në vitin 2003: "Bazeli II është më shumë një propozim për forcimin e menaxhimit të rrezikut sesa një propozim për përmirësimin e standardit të kapitalit".

Pjesa e parë përshkruan kontekstin e zbatimit të rregullores së re, arsyetimin pas çdo qasjeje, çfarë do të sjellë metoda standarde në termat e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kredisë, cilat janë mangësitë e kësaj metode për sistemin bankar shqiptar, cili është opsioni që nuk konsiderohet nga rregullorja, cilat janë sfidat e zbatimit të metodës IRB në Shqipëri dhe avantazhet e saj, dhe më në fund, në pjesën e tretë, është propozuar një instrument alternativ për një zbatim të besueshëm të Bazeli II, duke përdorur Regjistrin e Kredive.

## KONTEKSTI I ZBATIMIT TË RREGULLORES SË RE

Kërkesat e reja do të zbatohen për të gjitha bankat shqiptare. Metoda standarde që imponon rregullorja e re, propozon ndryshime në kërkesat e përgjithshme për kapitalin e bazuar në rrezikun dhe për përcaktimin e aktiveve të peshuara me rrezik në emëruarin e raportit të kapitalit. Rregullorja e re për sistemin bankar shqiptar, hyri në fuqi pothuajse 10 vjet pas finalizimit të metodës së standardizuar të Bazeli II.

<sup>4</sup> Roger W. Ferguson, Jr. është ekonomist amerikan, i cili ka qene Zëvendës-president i Bordit të Guvernatorëve të Rezervës Federale gjatë periudhës 1999-2006.

Vendimi për zbatimin e këtij opsiioni, për përcaktimin e kërkesave të kapitalit për rrezikun e kredisë, bazohet në shkallën e kompleksitetit të aktivitetit bankar në Shqipëri. Autoriteti rregullator ka deklaruar se bankat në Shqipëri nuk kanë kapacitetet e kërkuara në matjen dhe menaxhimin e rrezikut për t'u kualifikuar për zbatimin e metodës së avancuar.

Për sa kohë, që rregullimi konsistonte në qëndrimin "presim dhe shohim", bankat me kapital evropian në Shqipëri, të detyruara nga Direktiva Evropiane, i kushtuan kohë dhe burime zhvillimit të modeleve të brendshme me më shumë ndjeshmëri ndaj rrezikut, sipas metodës IRR të kuadrit të kapitalit. Të dhënat nga sistemi bankar shqiptar, për strukturën e kapitalit, tregojnë se kapitali i huaj vazhdon të kontribuojë më së shumti në strukturën e kapitalit, duke përbërë 92% të kapitalit të paguar në sistemin bankar.


Aktualisht, një pjesë e rëndësishme e sistemit bankar përgatit 2 raporte për mjaftueshmërinë e kapitalit, njërin si pjesë e përputhshmërisë për mbikëqyrjen e konsoliduar për vendin e origjinës së kapitalit dhe tjetrin, si pjesë e pajtueshmërisë për mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Situata në bankat shqiptare është e ndryshme nga koha kur u morr vendimi për zbatimin e metodës standarde. Bankat tashmë kanë një histori dhe kanë mbledhur dhe ruajtur shumë informacion në lidhje me aktivitetin e tyre kreditues.

Vendimi për të mos përfshirë metodën IRR, si një mundësi për t'u zgjedhur nga bankat për vendosjen e përqindjeve të kapitalit për rrezikun e kredisë, u bazua në konstatimin se bankave shpesh u mungojnë të dhënat historike dhe për këtë arsye, të paktën në një fazë të hershme, nuk mund të jenë në gjendje të zbatojnë vlerësime të brendshme të sakta. Gjithashtu, në atë kohë, tregu bankar ishte edhe më i vogël dhe bashkë me mungesën e të dhënave mbi dështimin e kredive, nuk ofronte mundësi për vlerësime objektive. Ky ishte një qëndrim i matur, pasi rreziku i kredisë është rreziku më i madh me të cilin përballlet sistemi bankar, sidomos në Shqipëri. Pavarësisht se metoda IRR është më e mirë, sa i takon menaxhimin të rrezikut, mbetet ende i pranishëm shqetësimi për mundësinë e zbatimit në praktikë të saj, si për bankat, ashtu edhe për mbikëqyrjen. Përveç faktit se tashmë, modele analoge të brendshme janë përdorur nga bankat për vendosjen e përqindjeve të kapitalit për rrezikun e tregut, ky rrezik është relativisht i parëndësishëm për pjesën më të madhe të bankave në Shqipëri, krahasuar me rrezikun e kredisë. Vlerësimi i gabuar i rrezikut të kredisë sjell rreziqe të konsiderueshme për mbikëqyrjen. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit i ndërtuar mbi të dhëna jo të plota, mund të sjellë rezultate të rrezikshme.

Mbi bazën e argumenteve mbi të dy opsionet, lind pyetja nëse metoda standarde, edhe pse më e thjeshtë, mund të vihet në dyshim për zbatim nga mungesa e të dhënave të disponueshme dhe të nevojshme për vlerësimin e rrezikut të kredisë. Të ngarkosh ECAI-n me këtë përgjegjësi, nuk do të thotë se problemi është zgjidhur.

Dihet se raporti i kapitalit varet nga klasifikimi i aktiveve sipas rrezikut, ndërsa klasifikimi i aktiveve sipas rrezikut reflekton vlerësimin e rreziqeve nga bankat.

Në grafikët e mëposhtëm janë paraqitur aktivet e peshuara me rrezik dhe raporti i kapitalit i llogaritur në bazë të tyre, për sistemin bankar shqiptar.



Grafiku i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit tregon se pavarësisht se raporti minimal rregullator për bankat në Shqipëri është 12%, në fakt, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) në fund të vitit 2013 ishte pothuajse 18%. Ky nivel i lartë është bazuar në shqetësimin mbi aktivet e ponderuara me rrezikun ose thënë më ndryshe, në shqetësimin mbi klasifikimin e duhur të aktiveve si pasqyrim i rrezikut të vërtetë. Këmbëngulja në të njëjtin nivel të RMK-së (12%), madje edhe në rregulloren e re (të gjitha vendet në përputhje me Bazel II e kanë nivelin e RMK-së 8%) pasqyron shqetësimin e mbikëqyrjes se rezultati i zbatimit të metodës standarde nuk mund të prodhojë një kapital rregullator në përshatje me rrezikun e vërtetë, që sistemi bankar do të përballet. A është niveli i RMK-së, i mbajtur në mënyrë të vjetër, një kompensim për mundësinë e nënvlerësimit të aktiveve të ponderuara me rrezikun, duke shmangur metodën e avancuar (IRR), si dhe nevojën e rregullave më komplekse të parametrave në modelet mbi rrezikun e kredisë?

## MATJA E RREZIQEVE PËRMES DY METODAVE TË NDRYSHME

Në Bazel II, ka dy opsione për matjen e rrezikut të kreditit: Metoda standarde dhe metoda e bazuar te vlerësimi i brendshëm (IRB).

Sipas metodës standarde, pesha e rrezikut duhet të përcaktohet duke iu referuar një vlerësimi të dhënë nga një institucion i jashtëm i vlerësimit të kreditit, që do të thotë se vlerësimi për kredinë do t'i korrespondojë një kategorie peshash të rrezikut, sipas tabelës së paracaktuar të konvertimit (shih Tabela 1).



Tabela 1.1 Peshat e rrezikut në metoden standarde

	AAA	AAA-	AA+	AA	AA-	A+	A	A-	BBB+	BBB	BBB-	BB+	BB	BB-	B+	B	B-	Below	unrated	Past due
Korporatat	20%			50%			100%			150%				100%	150%					
Sovrani	0%			20%			50%			100%				150%	100%	-				
Bankat	20%			50%			100%			150%				50%	-					
Bankat sipas vendit	20%			50%			100%			150%				100%	-					
Retail	75%																		150%	
Banesa hipotekare	35%																		100%	
Prona tregtare hipotekare	Nga 100% deri në 50% sipas rregullores së vendit																		150%	

Burimi: BIS.

Ekspozimet janë klasifikuar në një set me klasa aktive të standardizuara (sovrani, bankave, korporatave, shitjes me pakicë, të pronës hipotekare, pasurive të patundshme komerciale dhe aktive të tjera) dhe një peshë rreziku është aplikuar në çdo klasë, duke reflektuar shkallën relative të rrezikut të kredisë për këtë klasë. Numri i kategorive të rrezikut është relativisht i vogël (ekspozimet e korporatave për shembull, janë peshuar në 20%, 50%, 100% ose 150%); për ekspozimet e pavlerësuar, është përdorur një peshë rreziku fikse 100%. Nga ana tjetër, kjo siguron që bankat të cilat marrin rreziqet më të mëdha të mbajnë kapital shtesë për t'i mbuluar ato<sup>5</sup>.

Për të mos paraqitur shumë detaje<sup>6</sup>, me shembullin e mëposhtëm kuptohet se çfarë mund të presin bankat, të cilat në zbatim të metodës standarde, do të mbështeten në vlerësimet e ECAI-s për rrezikun e kredisë.

Shuma e kapitalit të kërkuar për një kredi të pasigurtë 1 euro për një firmë private - tani është fiksuar në 12 cent (12% x 1 euro), dhe në varësi të "vlerësimeve" të dhëna nga ECAI, do të jenë si më poshtë: do të ulët në 2.4 cent ose të rritet në 18 cent.

Vlerësime më të mira (lloji AAA-AA), do të sjellin pesha më të ulëta në lidhje me llogaritjen e aktiveve me rrezik;

Për shembull, një kredi 100 euro, për një kompani jofinanciare vlerësuar me AAA-, do të përkthehet në 20 euro aktive me rrezik dhe për këtë arsye, do të çojë në një kërkesë për kapital prej  $20 \times 12\% = 2.4$  eurosh (me fjalë të tjera, 2.4% e ekspozimit të paponduar).

Në mënyrë të ngjashme, një kredi 100 euro ofruar për një shtet sovran me një vlerësim më të ulët se B-, do të rritet në 150 euro ekspozim i peshuar me rrezik, kështu që kërkon një mbulim të kapitalit prej  $150 \times 12\% = 18$  eurosh (18% e vlerës nominale).

<sup>5</sup> Për më shumë detaje mbi kuadrin rregullator të Bazelit shiko Tarullo (2008) ose <http://www.bis.org/bcbs/index.htm>

<sup>6</sup> Detajet mbi mbështetjen teorike janë dhënë nga Komiteti i Bazelit për Bankingun (2005a) dhe Gordy (2003).

Metoda standarde ofron një metodë të thjeshtë për bankat, të cilat nuk kanë kapacitetet e nevojshme të matjes dhe menaxhimit të rrezikut për t'u kualifikuar për qasjet e avancuara. Megjithatë, duke vepruar nën këtë qasje, bankat mund të mos jenë të interesuara për të modernizuar sistemet e tyre të matjes dhe menaxhimit të rrezikut.

Gjithsesi, kjo metodë arrin ta paraqesë ndjeshmërinë e rrezikut vetëm në qoftë se të gjitha korporatat janë të vlerësuara "rated" dhe në qoftë se vlerësimet e përfituara nga ECAI-at, reflektojnë realisht profilet e tyre të rrezikut. Për një zbatim kuptimplotë të SA-së në Shqipëri, problemi kryesor mbetet depërtimi shumë i ulët i agjencive të vlerësimit të kredisë. Kjo do të thotë se shumica e kredive do të jenë të vlerësuara si 100%, pasi në mungesë të tregut të kapitalit, shumica e korporatave nuk janë të kuotuar. Korporatat e pavlerësuara pritet të përballen me të njëjtën peshë të rrezikut si në Bazel I dhe si rrjedhim, nuk priten ndryshime nga Bazel I në terma të peshave të rrezikut.

Në këtë situatë, pritet që ekspozimet me më shumë rrezik do të jenë më të favorizuar për sa i përket përqindjeve të kapitalit, kur ata janë thjesht të pavlerësuar (unrated), pasi kompanitë e pavlerësuar kanë një peshë më të ulët të rrezikut se kompanitë e vlerësuara me B dhe më poshtë. Një kompani e vlerësuar poshtë B-së, mbart një peshë rreziku 150%. Kjo do të thotë se bankat do të kenë një nxitje të kreditojnë një kompani të pavlerësuar në vend të një kompanie me një vlerësim më poshtë se B-. Kompanitë e dobëta nuk do të jenë të interesuara për t'u vlerësuar, sepse do të humbasin mundësinë për t'u kredituar. Nga ana tjetër, për shkak të aktivitetit të kufizuar të agjencive të vlerësimit në Shqipëri, çmimi i këtij shërbimi ka gjasa, të jetë i mbivlerësuar. Si pasojë, huamarrës të vegjël (edhe pse mund të jenë shumë të besueshëm për kredi), mund të mos përballojnë shërbimet e agjencive të vlerësimit dhe bankat do të prirën të kenë gjithnjë e më shumë huamarrës të mëdhenj në librat e tyre të kredisë. Në përgjithësi, zbatimi i metodës standarde, do të rrisë sjelljen joracionale të kreditimit ndaj huamarrësve të mëdhenj. Edhe në qoftë se një korporatë e madhe do të jetë në gjendje të përballojë shërbimet e një agjencie të vlerësimit të kredive, agjencitë e vlerësimit (CRA), duke qenë përballë të dhënave të kufizuara, mungesës së tregut të kapitalit dhe pasigurisë që sjell mospajtueshmëria e praktikave të kontabilitetit, ka shumë mundësi të përcaktojnë një vlerësim të ulët edhe për atë korporatë.

Më parë kam pohuar se depërtimi i ulët i industrisë së vlerësimit në tregun e Shqipërisë dhe pamjaftueshmëria e të dhënave në dispozicion, nuk mbështesin përdorimin e metodës së standardizuar në funksion të lidhjes së kapitalit me rrezikun. Nëse argumenti se të dhënat në dispozicion janë të kufizuara dhe nuk lejojnë zbatimin e metodës IRR është bindës dhe deri diku i kujdesshëm, po i njëjti argument se si këto të dhëna, të cilat edhe në rastin e metodës standarde janë përsëri të kufizuara, do të gjenden dhe do t'u shërbejnë agjencive të vlerësimit për të vlerësuar rrezikun e kredisë, mbetet për t'u parë.

Problemet e mundshme që mund të ndodhin në praktikë, në lidhje me saktësinë e vlerësimeve nga agjencitë, duhet të merren në konsideratë edhe më tepër

në rastin e Shqipërisë. (Për më shumë informacion mbi shqetësimet në lidhje me vlerësimet e kredive nga agjencitë e vlerësimit, shihni Vrioni Rreth ECAI Recognition<sup>7</sup>).

Disa skenarë të tjerë të mundshëm mund të merren parasysh, si për shembull sesa ECAI-s kanë të dhënat e nevojshme dhe të sakta për të arritur përfundimet e duhura. Mund të ndodhin raste kur vlerësimet e kryera brenda bankës të jenë më të sakta, duke pasur parasysh se bankat janë më të interesuara në vlerësimin e rrezikut të kredisë së klientëve të tyre, pasi janë ato që do të mbajnë përgjegjësitë e vlerësimeve të gabuara. Gjithashtu, bankat njohin më mirë tregun dhe mjedisin e biznesit etj. Të tillë skenarë janë hasur shpesh edhe në Evropë, ku agjencitë e vlerësimit funksionojnë dhe në rastin më të mirë, kanë dhënë vlerësime të sakta për vetëm 53% të të gjitha firmave DAX-30 që kanë pasur vlerësim kredie (rating).

Siç duket qartësisht, vlerësimi (rating) për kompanitë e vogla për hir të Bazel II, mund të shmanget. Në këtë rast, mekanizmat e vlerësimit të brendshëm të rrezikut nga vetë bankat janë të mjaftueshme. Bankat mund të rrisin vazhdimisht kompetencën e tyre nga ekspertiza e agjencive të vlerësimit. Vlerësimet (rating) e shpeshta nuk do të ishin efektive në termat e kostos për kompanitë, sidomos ato të voglat.

Pra, për të përmbledhur se çfarë sjell zbatimi i metodës standarde, po i rendis si më poshtë:

- Përdorimin e agjencive të jashtme të vlerësimit të rrezikut të kredisë;
- Përdorimin e peshës së rrezikut të përcaktuar të sovranit për të caktuar peshat e rrezikut për ekspozimet ndaj bankave;
- Përdorimin e raportit kredi/vlerë për peshën e rrezikut të hipotekave të banesave;
- Peshën e rrezikut më të ulët për disa ekspozime të shitjes me pakicë dhe kredi të vogla për bizneset;
- Zgjerimin e gamës së teknikave për zbutjen e rrezikut të kreditit, të cilat janë të njohura për qëllime të kapitalit të bazuar në rrezik, duke përfshirë zgjerimin e gamës së kolateralit të pranuar dhe garantuesit të njohur;
- Rritjen e faktorit të konvertimit të kreditit për angazhime të caktuara me një maturitet fillestar prej një viti ose më pak, që nuk janë të anulueshme pa kushte;
- Rishikimin e peshave të rrezikut për ekspozimet e titullzimeve etj.

## KOSTOT E ZBATIMIT TË METODËS STANDARDE

Pavarësisht faktit se metoda konceptualisht është e thjeshtë (ekspozimi x peshë), zbatimi i saj për bankat është kompleks. Gjithashtu, edhe trajtimi i kolateralit është një çështje komplekse. Transpozimi i tekstit të Bazelit në rregulloren (CRR) është ndonjëherë i vështirë për t'u interpretuar (DIR ka 13 anekse me më shumë

<sup>7</sup> [http://www.bankofalbania.org/web/Bulletin\\_of\\_the\\_Bank\\_of\\_Albania\\_H\\_II\\_2013\\_7076\\_2.php?kc=0,22,11,0,0](http://www.bankofalbania.org/web/Bulletin_of_the_Bank_of_Albania_H_II_2013_7076_2.php?kc=0,22,11,0,0)

se 200 faqe dhe nenet e Direktivës dedikuar caktimit të peshave të rrezikut përmendin shumë raste të veçanta, të cilat sjellin kompleksitet në zbatim).

Metoda standarde krijon sfida të rëndësishme për bankat shqiptare, pasi ato duhet të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme metodat dhe standardet e brendshme në mbledhjen dhe raportimin e informacionit për llogaritjen e aktiveve me rrezik.

Për shembull, siç edhe përshkruhet në metodën standarde për bankat, do të jetë "e nevojshme të ndryshojnë procesin e tyre të raportimit të brendshëm", do të duhet të ofrojnë "trajtime shtesë për personelin dhe shpenzimet që lidhen me sistemet e reja (ose modifikimin e sistemeve ekzistuese) dhe "të sigurojnë informacion shtesë në mënyrë që të përcaktojnë peshat e duhura të rrezikut". Sipas metodës standarde, mbledhja dhe raportimi i informacionit për të llogaritur aktive me rrezik nga bankat në përcaktimin e kërkesave për kapital rregullator, do të përdoret vetëm për të qenë në përputhje me rregulloren, sepse informacioni nuk do të përdoret në menaxhimin e përditshëm të rrezikut.

Ende nuk është mjaft e qartë nëse pesha e standardizuar e rrezikut do të reflektojë rrezikun aktualisht të observuar të një aktivi të caktuar ose rrezikun e ndërlidhur ndërmjet klasave të aktiveve, sepse metoda standarde nuk merr në konsideratë ndryshime të papritura në kushtet ekonomike në përgjithësi apo të një sektori të veçantë. Në këto kushte, disa nga peshat fikse të rrezikut ose do të mbivlerësojnë ose nënvlerësojnë rreziqet aktuale.

Po kështu, koeficientët e ngjashëm të rrezikut për të njëjtën kategori klientësh (klasë aktivesh), pavarësisht nga fitimi apo modeleve të ndryshme biznesi dhe mjedisit ekonomik, duhet të vlerësojnë nëse do të mundësojnë lidhjen e kapitalit me rrezikun. Bankat bashkëpunojnë me huamarrësit për të gjetur zgjidhje funksionale për nevojat e kreditimit të tyre, duke mundësuar për bankat më shumë kategori të kredive, që shpesh nuk përputhen me kategoritë standarde të favorizuara nga metoda standarde.

Metoda standarde u kërkon bankave kryerjen e shpenzimeve dhe lë pak hapësirë për përfitimet e mundshme nga përdorimi i modeleve të brendshme, më shumë të ndjeshme ndaj rrezikut, sipas metodave më të avancuara të kuadrit të kapitalit. Përveç kostove të pajtueshmërisë që lidhen me kryerjen e llogaritjeve për dy raporte të mjaftueshmërisë së kapitalit, kjo metodë i stimulon pak bankat për të zhvilluar metodologjitë e brendshme dhe përditësuar ato me qëllim identifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

Kërkesat e metodës së standardizuar nuk duhet të konsiderohen në mënyrë të izoluar, por së bashku me zhvillimin dhe ndryshimet e ardhshme të propozuara në Bazel III, dhe gjithashtu, në përputhje me qëndrimin dhe objektivin e rregullatorëve evropianë. Kështu, që nga nëntori i vitit 2013, rregullatorët evropianë (Komiteti i Përbashkët i Autoriteteve Mbikëqyrëse Evropiane (EBA, Esmā dhe EIOPA) miratuan objektivin për të ulur vartësinë nga vlerësimet (ratings) e jashtme në rregullimin financiar, kryesisht në Evropë.

Gjithashtu, pas krizës, në raportin e IIF-së të vitit 2009 "Rivendosja e Besimit", në seksionin 4, me titull "Stabiliteti Financiar nëpërmjet Mbikëqyrjes Makroprudenciale", për industrinë bankare rekomandohet:

"Përmirësime në modelet e brendshme të rrezikut:

Mbështetja e tepërt në "vlerësimet e jashtme" në modelet e brendshme të rrezikut, do të thotë se menaxhimi i lartë në disa firma nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndjeshmërinë e rreziqeve ndaj supozimeve të bëra. Një rishikim në qasjen e modeleve të brendshme të rrezikut po vë theksin në masa plotësuese të tilla si, stres testet e forta."

Parë dhe nga këndvështrimi i stabilitetit financiar<sup>8</sup>, për sistemin bankar në tërësi nuk do të ishte e kujdesshme nëse bankat do të përdornin metodën standarde si mjetin kryesor të tyre për menaxhimin e rrezikut. Metoda standarde do të inkurajojë të gjitha bankat të sillen në të njëjtën mënyrë, duke rritur rrezikun sistematik. Kryerja e veprimtarisë bankare në mënyra dhe modele të ndryshme është më e këshillueshme pasi gjeneron më pak korrelacion.

Në shumë studime, në mënyra të ndryshme, është sugjeruar opinioni i shprehur edhe nga Peter Sands se "në fushën e bankave thjeshtësia e tepruar mund të jetë e rrezikshme". Po ashtu, në Financial Times, më 26 gusht 2013, shkruhet: "Thjeshtësia e SA-së, e cila në fillim ishte virtyti i saj më i madh, në një sistem financiar më kompleks, bëhet dështimi i saj më i madh. Bota financiare është bërë më komplekse dhe bota rregullative duhet të lëviz po me këtë hap. Çështja, pra, nuk është nëse marrëveshjet rregullative duhet të modernizohen, por se si ato mund të arrihen në mënyrë të balancuar dhe në një kohë të arsyeshme."

Spektori bankar përdor metodologji dhe teknologji të sofistikuar po aq sa edhe sektorët e tjerë. Për më tepër, kompleksiteti i industrisë bankare reflekton evoluimin e ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi. Dekurajimi i përmirësimit të mëtejshëm apo i përdorimit të mjeteve të sofistikuar të menaxhimit të rrezikut nuk do të çojë në një botë më të thjeshtë, por përkundrazi, do ta bënte më të vështirë dhe komplekse për ta menaxhuar atë në mënyrë të përshtatshme.

Lejimi i përdorimit të matjeve të brendshme të rrezikut për bankat është një inovacion i rëndësishëm, i cili zvogëlon gjasat që kuadri rregullator të vjetërsohet, si rezultat i zhvillimeve në novacionet financiare dhe teknikave të menaxhimit të rrezikut. Përveç kësaj, avantazhi i informacionit që bankat kanë, mund të shfrytëzohet më mirë për të arritur në një përjasje më të saktë ndërmjet kapitalit rregullator dhe nivelit të synuar të kapitalit ekonomik. Së fundi, duke e vendosur përgjegjësinë në mënyrë të qartë mbi menaxhimin, bankat detyrohen të zhvillojnë sisteme të brendshme të menaxhimit të rrezikut.

<sup>8</sup> Mund të vihet re se në materialin e diskutimit të FMN-së "Revisiting Risk-Weighted Assets" (Mars, 2012), i qëndrohet të njëjtës analizë.

## METODA E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (IRB)

Ka studime të shumta<sup>9</sup> dhe modele të ndërtuara nga bota akademike në lidhje me metodën e modeleve të Bazel II dhe duket se në themel të marrëveshjes, është si të thuash, formalizmi i modelimit ekonomik. Gjetja e përbashkët e të gjitha këtyre studimeve është se cilësia e një modeli varet nga cilësia e inputeve të tij.

E drejta për t'u pranuar metoda IRB nën Bazel II<sup>10</sup> përcaktohet nga disa kërkesa për menaxhimin dhe për kontrollet e brendshme të bankës. Por për vendosjen e kërkesave për kapital dhe për rrezikun e kredisë në veçanti, me interes janë kërkesat sasiore për sistemin e vlerësimit të bankës dhe disponueshmërinë e të dhënave të caktuara.

Ka dy metoda IRB: ajo "foundation" dhe ajo "advanced". Udhëzimet e BIS sugjerojnë se "foundation" IRB është më mirë të aplikohet në vendet, ku aktiviteti bankar është kryesisht veprimtari pakice. Sipas këtij sugjerimi, meqenëse aktiviteti bankar në Shqipëri është kryesisht me pakicë, metoda "foundation" IRB mund të jetë opsioni për t'u marrë në konsideratë.

Sipas metodës IRB, shpërndarja e ekspozimeve të portofoleve ndjek të njëjtat rregulla si në metodën SA, përveç se numri i klasave të aktiveve është më i lartë.

Klasat e aktiveve janë sovrani, bankat, korporatat (të cilat ndahen në ekspozime ndaj ndërmarrjeve të vogla, të mesme, kreditime të specializuara, blerje për t'u arkëtuar dhe ekspozime të tjera të korporatave), pakica (ndahen në kredi hipotekare për shtëpi, ekspozime të ripërsëritura të kreditit, të arkëtueshme dhe të tjera me pakicë, përfshirë kreditë për bizneset e vogla) dhe ekspozime të kapitalit neto për të cilat aplikohen pesha rreziku të ndryshme.

Në metodën IRB, peshat e rrezikut janë të bazuara në vlerësimet e brendshme që bankat u bëjnë huamarrësve të tyre. Që bankat të lejohen për këtë opsion, duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

- Banka duhet të ketë përdorur një sistem vlerësimi, të paktën tre vjet para se të kualifikohet për qasjen IRB;
- Gjatësia e periudhës së vëzhgimit për të dhënat e përdorura për vlerësimin e probabilitetit të dështimit (PD) nga banka duhet të jetë të paktën pesë vjet;
- Gjatësia e periudhës së vëzhgimit për të dhënat e përdorura për të vlerësuar humbjen nga dështimi (LGD) dhe ekspozimin në dështim (EAD) duhet të jetë të paktën shtatë vjet, me përjashtim të ekspozimeve me pakicë për të cilat afati është pesë vjet.

<sup>9</sup> *Bank regulation, capital and credit supply: Measuring the impact of Prudential Standards* William Francis Matthew Osborne UK Financial Services Authority

<sup>10</sup> *Enhancements to the Basel II Framework* July 2009 Bank of International Settlement Publications <http://www.bis.org/publ/bcbs157.htm>

Në qoftë se këto kushte janë plotësuar dhe bankat lejohen për të krijuar sistemin e tyre të vlerësimit (në vend të varësisë nga agjencitë e jashtme të vlerësimit), kapitali përkundër çdo ekspozimi të kredisë do të jetë në funksion të katër parametrave bazë të rrezikut: probabiliteti i dështimit (PD), humbja nga dështimi (LGD), ekspozimi në dështim (EAD) dhe maturiteti i mbetur i ekspozimit (m) të portofolit të kredisë, të cilit i takon ekspozimi.

Në metodën "IRB foundation", PD-ja gjithmonë duhet të vlerësohet nga bankat, ndërsa LGD-ja, EAD-ja dhe M-ja nga mbikëqyrja.

Parametrat e mësipërm të rrezikut janë inputet e nevojshme për të vlerësuar rrezikun e kredisë të një huaje të vetme, kështu:

PD-ja është probabiliteti i dështimit për një huamarrës gjatë një periudhe një-vjeçare, që njihet edhe si frekuenca e pritshme e dështimit. Matja e PD-së bazohet në vetë përkufizimin e dështimit. Në përgjithësi, dështimi ndodh nga mos-pagesa e principalit ose e interesit. Është gjerësisht e pranuar se dështimi ndodh nëse pagesa nuk kryhet brenda 90 ditëve. Këto kredi karakterizohen si "me probleme".

EAD-ja është sasia e pritshme e humbjes në një kredi të ofruar për një huamarrës, kur ndodh dështimi.

LGD-ja është shuma që huamarrësi detyrohet në kohën e dështimit, pra, ekspozimi i mbetur në kohën dështimit.

Humbja e pritshme është një shumëzim i thjeshtë i  $(PD * LGD * EAD)$ . Konvertimi në peshë të rrezikut rrjedh nga formula analitike, që lidh kërkesat për kapital me komponentin e humbjeve të papritura të kredisë (UL), me idenë se komponenti i humbjeve të pritshme (EL) mbulohet tashmë nga provigjonet. Pra metoda "IRB foundation", përmban një thjeshtësim të qëllimshëm në krahasim me teknikat më të avancuara që aplikohen aktualisht.

Ky thjeshtësim lejon që një model të mund të standardizohet dhe kështu, të aplikohet në mënyrë të unifikuar nga bankat me madhësi të ndryshme dhe kompozim të ndryshëm të portofolit. Horizonti kohor i vlerësimit të rrezikut është vendosur në një vit. Modeli IRB, gjithashtu, supozon një nivel të besimit 99,9%. Për më shumë detaje, shih Resti (2002).

## PËRFITIMET E MODELEVE TË BRENDSHME

Aplikimi i një kuadri kapitali, i bazuar te ndjeshmëria e rreziqeve, ka rezultuar të ketë avantazh si për bankat dhe për mbikëqyrësit. Në mënyrë që bankat të kualifikohen për të drejtën e përdorimit të metodës së modelit të brendshëm, duhet të vërtetojnë te mbikëqyrësit, që informacioni i i mbledhur është përdorur jo vetëm për të përcaktuar kërkesat e kapitalit rregullator, por edhe gjatë kryerjes së veprimtarisë së përditshme, sidomos në menaxhimin e rrezikut. Sistemet e menaxhimit të rrezikut, brenda një banke, mund të përmirësohen

në disa mënyra, përmes përdorimit të modeleve të brendshme. Mbledhja e të dhënave të besueshme historike, mbi dështimin dhe humbjen e kredive për modelet e brendshme, kërkon një përpjekje serioze me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit, që përdoret për menaxhimin e rrezikut.

Një studim nga *Task Force* i CEPS për Bazel II, i kryer pas krizës, ka gjetur se: "Modelet e kreditit bëjnë të mundur vlerësimin e gradave të portofolit në terma të PD-së, duke krijuar një matës të përbashkët dhe objektiv për të gjithë klientët. Kjo ofron një përparim të madh, krahasuar me modelet e mëparshme apo proceset manuale që rendisnin klientët me grada".

Analizat e studimeve të impaktit të Bazel II nga BIS, kanë treguar se përdorimi i modeleve në veprimtarinë bankare të përditshme, ka përmirësuar vlerësimin e procesit të "rrezik-rikthimit", duke i siguruar menaxhimin të dhënave mbi "marzhin" e kredisë, si vija e parë e mbrojtjes kundrejt humbjeve të kredisë.

Zëvendësimi i metodologjisë së kontabilitetit "humbjes së ndodhur" me qasjen më largpamëse, bazuar në përkufizimin e kontabilitetit financiar të "humbjes së pritshme" është bazuar në modelin IRR. Modelet IRB mund të luajnë një rol, jo vetëm për të përcaktuar kapitalin minimal të kërkuar, por edhe duke mbështetur kërkesat e kontabilitetit në caktimin e provigjoneve për zhvlerësimin e kredisë, të cilat pas të ardhurave bruto përbëjnë vijën e dytë të mbrojtjes kundër humbjeve të kreditit.

Përdorimi i modeleve të brendshme për rrezikun e kredisë, sipas përkufizimit, e kthen kapitalin rregullator nga një përqindje fikse në një përqindje të ndjeshme ndaj rrezikut dhe si i tillë, mbështet stabilitetin financiar.

## NJË OPSION PËR T'U KONSIDERUAR PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Për sa me sipër, sfida për të lejuar bankat të përdorin modelin e brendshëm është e kushtëzuar nga disponibiliteti i të dhënave të besueshme dhe të përshtatshme. Nëse të dhënave të mjaftueshme dhe të nevojshme janë të mundshme, kjo është një pyetje që duhet të konfirmohet nga ndonjë studim empirik apo pyetësor.

Pavarësisht studimeve sasiore mbi impaktin e zbatimit të Bazelit, të kryera nga Komiteti i Bazelit, ato nuk përfshijnë tregun financiar shqiptar. Kjo është arsyeja pse unë besoj se rregullorja e re do të kishte qenë më efektive, në qoftë se mbikëqyrja do të kishte kryer më parë një studim empirik (versioni shqiptar) të ndikimit të rregullores për të gjitha segmentet e sektorit bankar shqiptar, klientët e bankës dhe ekonominë shqiptare. Në vend të kryerjes së një analize të thellë sasiore për sistemin bankar shqiptar, mbikëqyrja është mjaftuar në deklaratat të përgjithshme për të justifikuar imponimin e metodës standarde dhe për sigurimin e të dhënave të nevojshme për zbatimin e Bazel II ka ngarkuar me përgjegjësi dy tregjet; atë të bankave dhe atë të agjencive të vlerësimit. A është kjo zhvendosje e përgjegjësisë në përputhje me politikën e qëndrueshme të rregullimit?



Tashmë, të dhënat ekzistojnë edhe në nivelin e bankave që prej më shumë se pesë vjetësh, që kur ato filluan mbledhjen e tyre. Sigurisht, që për kalibrimin e modeleve dhe për testimet e tyre, janë të nevojshme shumë më tepër të dhëna, por udhëzimet e EBA-s ofrojnë të gjitha mundësitë për zgjidhje të përshtatshme. Dokumentet konsultative të BE-së kanë propozuar krijimin e një baze të dhënash të përbashkëta me vlerësimet nga bankat, për të lehtësuar zbatimin e metodës IRB, në veçanti nga bankat më të vogla. Disa vende në kushte të ngjashme me vendin tonë, janë tani në përputhje me Bazel II dhe nuk vonuan në përmbushjen e afateve për zbatimin e Bazel III në sistemin e tyre bankar. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë, informacioni i mbledhur nga Regjistri i Kredive.

## INFORMACIONI I REGJISTRIT TË KREDIVE

Shumë studime<sup>11</sup> (shih referencat) kanë treguar se disponueshmëria e parametrave të metodës IRB – probabiliteti i dështimit (PD), humbjet (LGD), faktori i konvertimit të kredisë (CCF) - lejon vlerësimin e humbjes së pritshme.

Andrew Pauell në artikullin e tij mbi Bazel II dhe vendet në zhvillim<sup>12</sup>: “*Sailing through the Sea of Standards*” propozon një metodë të centralizuar vlerësimi, si një mënyrë tranzitore.

Ai sugjeron që Regjistri i Kredive është një burim informacioni i dobishëm për të vlerësuar probabilitetin e dështimit, si dhe parametra të tjerë për krijimin e modeleve të rrezikut të kredisë.

Regjistri shqiptar i Kredive, ka filluar të operojë në Bankën e Shqipërisë që nga 3 janari 2008. Bankat raportojnë kreditë e reja dhe përditësojnë statusin e ri të pagesës së kredisë në fund të çdo muaji. Regjistri përmban informacion pozitiv dhe negativ mbi huamarrësit dhe këto të dhëna ruhen në Regjistër për 5 vjet. Shqetësimi im është se ky informacion duhet të ruhet në një sistem *back-up*, për qëllime të vlerësimit statistikor të rrezikut të kredisë. Edhe në rregulloren e Regjistrit të Kredive qëllimi është i përkufizuar “Përdorimin dhe/ose publikimin e informacionit nga Banka e Shqipërisë për kërkime dhe qëllime të tjera statistikore, në mbështetje të procesit mbikëqyrës”.

Me një gjuhë të thjeshtuar, jo teknike, parametrat e nevojshme për IRB-në mund të shprehen si më poshtë:

- Probabiliteti një-vjeçar i dështimit të një klienti (mospagimit) e përcaktuar nga ana e bankave, nëpërmjet vlerësimit të brendshëm (frekuenca e dështimit të pritshëm);
- Kontrata të veçanta, të dhëna në raste të dështimit të pritur: lloji i kolateralit; përqindja e mbulimit të kolateralit (raport i kredisë me vlerën);
- Ekspozimi i kontratës në raste dështimi;
- Maturimi i kontratës;
- Granulariteti i portofolit.

<sup>11</sup> Studime të Daniel Porath si për shembull studimi “*Estimating probabilities of default for German banking system*”.

<sup>12</sup> *World Bank Policy Research Working Paper 3387, September 2000.*

Sipas metodës "foundation" IRB, vetëm probabilitetet e dështimit duhet të vlerësohen nga bankat, ndërsa faktorët e tjerë do të vendosen nga mbikëqyrësi. Bankat vlerësojnë një PD për çdo gradë dhe kategori vlerësimi. Vlerësime të tilla duhet të bazohen në mesataret afatgjata të normave të dështimit një-vjeçar.

Regjistri i Kredive do të ndihmojë në grumbullimin e informacionit mbi parametra të tjerë. Sfida për Regjistrin e Kredive do të jetë nevoja për klasifikimin e informacionit ekzistues, sipas klasifikimit të Bazelit. Disa transformime dhe përpunime të të dhënave do të nevojiten, si një procedurë rikonsultimi, për të identifikuar çdo ekspozim në klasën përkatëse.

Regjistri i Kredive përfshin informacion mbi karakteristikat e çdo kredie, si vijon: lloji i instrumentit (kredi tregtare, kredi financiare, me qira etj), llojin e monedhës, maturitetin, nëse ekziston kolateral apo jo, llojin e garantuesit, mbulimin me garanci, shumën e tërhequr dhe e pa tërhequr e një angazhimi të kreditit, si dhe më e rëndësishmja, nëse kredia performon normalisht apo ka vonesa (dallimin mes kredisë me probleme dhe statusit të dështimit). Regjistri i Kredive, gjithashtu, përfshin informacion në lidhje me karakteristikat e huamarrësve.<sup>13</sup>

Në literaturë përmenden disa vende, të cilat kanë zbatuar Bazel II, duke përdorur të dhënat e Regjistrin të Kredive, të tilla si Spanja dhe Argjentina.

Duke ndjekur hapat logjikë që udhëzimet sugjerojnë, një mënyrë për të vlerësuar parametrat do të ishte:

Së pari, banka duhet të caktojë një gradë (vlerësim) për huamarrësin sipas:

- a) karakteristikave të rrezikut të kredimarrësit;
- b) karakteristikave të rrezikut të transaksionit që do të kryhet, duke përfshirë produktin apo llojin e kolateralit ose të dyja dhe vlerëson dhe komponentët e rrezikut.

Gradat e vlerësimit, të cilat njësohen sipas aftësisë së huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale, të kryera mbi bazën e të gjithë informacionit sasior dhe cilësor, të arsyeshme e të arritshme dhe të shprehura në terma të një vlerësimi rendor. Gradat e vlerësimit janë renditur në bazë të rrezikut të kredisë. Probabiliteti që një huamarrës të dështojë rritet ndërsa ai lëviz nga një shkallë më e ulët në një shkallë më të lartë të rrezikut. Përkufizimi i dështimit është i njëjtë si në Bazel II: të paktën 90 ditë vonesë, dështim për të përmbushur detyrimet financiare.

Qasja empirike përdor të dhënat historike të dështimit për të karakterizuar huamarrësit në dështim, të kryera me *logit* ose *probit regresion*, për të përcaktuar një funksion grade *S* e formës:

$$S(x_i) = b_1x_1 + b_2x_2 + \dots + b_nx_n$$

<sup>13</sup> Për më shumë mbi Regjistrin shqiptar të Kredive [http://www.bankofalbania.org/web/Credit\\_Registry\\_3306\\_2.php?kc=0,8,7,0,0](http://www.bankofalbania.org/web/Credit_Registry_3306_2.php?kc=0,8,7,0,0)

Vektori x përmban faktorët e rëndësishëm të rrezikut, të cilët ndryshojnë në bazë të karakteristikave të huamarrësit. Pra, për huamarrësit si biznes, vektori x mund të përfshijë raporte të pasqyrave financiare, të dhënat e tregut etj, ndërsa për huamarrësit individë, mund të përfshihen të ardhurat, historia e punës dhe të dhënat e tjera demografike.

Modeli statistikor gjeneron një gradë që rendit huamarrësit në bazë të probabilitetit të tyre të dështimit. Pas kësaj, banka do të plotësojë kurbën e PD-së, përkatësisht për përqindjen e rrezikut, sipas grafikut të propozuar nga udhëzimet e BIS.

Më pas, mbikëqyrësi ka për të vlerësuar parametrat e tjerë. Informacioni i nevojshëm për shpjegimin e LDG-së është lloji i kolateralit; përqindja e mbulimit të kolateralit (raport kredi mbi vlerë). Të gjitha këto të dhëna mund të gjenden në Regjistrin e Kredive.

Një shembull i vërtetë është paraqitur nga Gabriele Sabato dhe Markus M.Schmid në materialin e tyre "Estimating conservative Loss given default".

Vlerësimi është bërë nga mesatarja afatgjatë e ponderuar e dështimit LGD. Kjo mesatare është llogaritur për çdo kategori. Për çdo periudhë të konsideruar (muaj ose vit), numri i defaults i ndodhur në këtë periudhë duhet të përdoret për të ponderuar mesataren përfundimtare të llogaritur, duke ndjekur hapat si në tabelën më poshtë:




Table 1.2: Mesatarja afatgjatë e ponderuar e dështimit LGD

Hapat	Credit ID Year X1	EAD	Recoveries (discounted)	Costs (discounted)	Economic loss (EAD-(Rec-Costs))	EL/EAD për Credit
Hapi 1.	AB01	125.000	52 000	12500	85500	68 %
	AB02	95.000	55 000	3500	43500	46 %
	AB03	100.000	40 000	6000	66000	66 %
	AB04	100.000	40 000	6000	66000	66 %
Hapi 2.	mesatarja e një viti					246 %
	Dështimi i ponderuar për vitin X1 Default-weighted LGD Year X1 = (1/4 x 68 %) + (1/4 x 46%) + (1/4 x 66%) + (1/4 x 66%) = 61.5%					
(mesatarja në vite)						
Hapi 3	Viti		dështimi i ponderuar LGD		Nr i dështimeve	
	X1		61.5 %		4	
	X2		55.4 %		3	
	X3		61.3 %		5	
	X4		65.4 %		7	
	X5		65.2 %		8	
27						
Hapi 4.	(mesatarja e ponderuar e dështimeve LGD)					
	= (4/27 x 61.5%) + (3/27 x 55.4%) + (5/27 x 61.3%) + (7/27 x 65.4%) + (8/27 x 65.2%)					
(mesatarja e ponderuar në vite): 62.9%						

Një version shumë më i thjeshtë i IRB-së është propozuar nga Gersbach A dhe Wehrspohn, që nga viti 2001. Autorët kanë aplikuar formulën e tyre, duke stimuluar ushtrime me portofol real të bankës. Ne mund të marrim në konsideratë këto aplikime të tjera nga fusha akademike për vlerësimin, duke përdorur Regjistrin e Kredive. Parametrat e vlerësuar për të gjithë popullsinë e bankave mund të kapërcejnë problemin e mungesës së të dhënave të përmendura më lart dhe në të njëjtën kohë, mund të përdoren si standarde për t'i krahasuar me ato parametra të përcaktuara nga bankat individuale. Nivele objektive (*floor*) mund të përcaktohen në kuadër të formulës IRB, mbi aktivet e peshuara me rrezik (RWA-ve). Disa nga këto nivele, janë sugjeruar edhe nga analiza dhe studimi i impaktit të fundit të BIS, për secilën kategori të aktiveve, të tilla që PD-ja nuk duhet të jetë më pak se 0.05% për ekspozimin ndaj sovranit dhe LGD të jetë 45%.

Gjithsesi, në rastin tonë është e këshillueshme që para se të ndërmerren hapa të tjerë përpara, në drejtim të vlerësimit të parametrave të IRR "*foundation*", të konsultohet dhe të kërkohet ndihmë nga vende që tashmë e kanë zbatuar Bazel II, përmes informacionit të grumbulluar në Regjistrin e Kredive.

Zbatimi i Bazel II, si bashkëpunim mes bankave dhe mbikëqyrjes, është një kontribut i rëndësishëm i metodës modelore, e cila përveç një matje më të saktë të rrezikut, do të sjellë dhe një kuptim më të mirë të natyrës së rrezikut, si për mbikëqyrësit dhe për bankat.

## PËRFUNDIM

Rregullorja e re e Bankës së Shqipërisë "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", e cila hyri në fuqi më 31 dhjetor 2014, vendos për bankat zbatimin e metodës standarde (e thjeshtë) për llogaritjen e rrezikut të kredisë. Kjo metodë standarde siguron që bankat të cilat marrin rreziqe më të mëdha të mbajnë më tepër kapital shtesë. Lënia e përgjegjësisë së vlerësimit të rrezikut të kredisë mbi ECAI-at, mund të mos sjellë një impakt të konsiderueshëm në drejtim të menaxhimit të rrezikut. Nga ana tjetër, mungesa e të dhënave të mjaftueshme për rastet e dështimeve të kredisë nuk mbështet zbatimin e metodës IRB. Në këtë kuadër, ky material sugjeron një metodë alternative dhe tranzitore për vlerësimin e rrezikut të kredisë.

Përdorimi i informacionit të mbledhur që nga viti 2008 në Regjistrin e Kredive, si dhe informacioni i brendshëm i bankave mund të çojë në një mënyrë realiste të zgjidhjes. Regjistri i Kredive është një burim i dobishëm, që mund të përdoret nga mbikëqyrja në vlerësimin e parametrave të rrezikut, të nevojshme për zbatimin e metodës IRB "*foundation*", së bashku me sistemin e brendshëm të bankave.

## REFERENCA

- Basel Committee on Banking Supervision (2006): "International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards", Bank for International Settlements, Basel
- "Enhancements to the Basel II Framework" July 2009 Bank of International Settlement Publications <http://www.bis.org/publ/bcbs157.htm>
- BCBS (2010b), "An assessment of the long-term economic impact of stronger capital and liquidity requirements", Bank for International Settlements (BIS), Basel Committee on Banking Supervision (BCBS), Basel,
- Gordy M. B. (2003): A Risk-Factor Model Foundation for Ratings-Based Bank Capital Rules, *Journal of Financial Intermediation* 12: 199-232
- William Francis Matthew Osborne UK Financial Services Authority "Bank regulation, capital and credit supply: Measuring the impact of Prudential Standards"
- Andrew Powell "Basel II and Developing Countries: Sailing through the Sea of Standards World Bank Policy Research Working Paper 3387
- Gersbach Hans , Wehrspohn Uwe. "Lean IRB Approaches and transition Design: the Basel II Proposal 2001
- Gabriele Sabato and Markus M. Schmid "Estimating conservative Loss given default"
- Leonid V. Philosophov, D. Sc., Professor "Assessing Validity of the Basel II model in measuring risk of credit portfolios"
- Sironi, Andrea, Altman, Edward I., Brady, Brooks and Resti, Andrea, "The Link between Default and Recovery Rates: Implications for Credit Risk Models and Procyclicality" (April 2002). Available at SSRN are all the studies of Andrea Resti [http://papers.ssrn.com/sol3/cf\\_dev/AbsByAuth.cfm?per\\_id=223524](http://papers.ssrn.com/sol3/cf_dev/AbsByAuth.cfm?per_id=223524)
- Michael Jacobs, . Office of the Comptroller of the Currency "An Empirical Study of Exposure at Default" June 2008
- Lindita Vrioni "About ECAI Recognition" available at [http://www.bankofalbania.org/web/Bulletin\\_of\\_the\\_Bank\\_of\\_Albania\\_H\\_II\\_2013\\_7076\\_2.php?kc=0,22,11,0,0](http://www.bankofalbania.org/web/Bulletin_of_the_Bank_of_Albania_H_II_2013_7076_2.php?kc=0,22,11,0,0)

## TABELAT BURIME-PËRDORIME DHE INPUT-OUTPUT TË SHQIPËRISË: STRUKTURA DHE MULTIPLIKATORËT

*Enian Çela, Departamenti i Kërkimeve*

### 1. HYRJE

Në shkurt të vitit 2015, INSTAT ka botuar të ashtuquajturat Tabela të Kontabilitetit Social (Instat, 2014). Këto statistika janë projektuar për të paraqitur totalin e transaksioneve që zhvillohen në një ekonomi brenda një afati kohor të caktuar, duke harmonizuar përfaqshjen e prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave.

Në botimin e INSTAT-it përfshihen 7 tabela: 3 tabela të burimeve (2009-2011), 3 tabela të përdorimeve (2009-2011) dhe një tabelë input-output (2011). Të gjitha statistikat paraqiten në terma vjetorë nominalë të disagreguar në 25 sektorë të ekonomisë. Mendohet që në publikimet e ardhshme të përfshihen edhe të dhënat në terma realë, duke mundësuar një analizë të çmimeve.

Në këtë material synohet fillimisht prezantimi i tabelave përkatëse, duke theksuar veçoritë e secilës prej tyre, strukturën e përgjithshme dhe formatin e statistikave të përfshira. Në vijim do të paraqiten multiplikatorët standardë të prodhimit, vlerës së shtuar, importeve dhe produktit të brendshëm që burojnë prej këtyre tabelave, duke u ndalur shkurtimisht në analizën e secilit. Multiplikatorët do të pasohen nga një përshkrim i përgjithshëm i strukturës ekonomike industriale, duke vënë në dukje disa pika të forta dhe rreziqet e përgjithshme që mund t'i kanosen ekonomisë në kuadër të strukturës ekzistuese. Në përfundim, do të veçohen disa nga përdorimet e mundshme më të thelluara që karakterizojnë tabelat në fjalë.

### 2. TABELAT

Statistikat e kontabilitetit social i kanë fillësat në tabelat Input-Output të transaksioneve ekonomike sugjeruar nga ekonomisti i njohur Vasili Leontief (Leontief, 1936). Me kalimin e viteve, statistikat e këtij lloji kanë ardhur duke u përmirësuar, megjithatë, gjithmonë kanë ruajtur frymën sikurse në çastin kur u paraqitën për herë të parë. Modeli input-output që buron nga këto statistika ka qenë baza fillestare e konceptit të ekuilibrit të përgjithshëm kontabël dhe ka gjetur përdorim të gjerë në analiza industriale dhe sektoriale. Një tabelë e përgjithshme input-output mund të shpërbëhet në nënkomponentë, të cilët shpjegohen në seksionet më poshtë.

## 2.1 TABELA E PËRDORIMEVE

Formati i tabelës së përdorimeve sipas raportimit të INSTAT-it është paraqitur në Shtojcën 1. Në kolonën e parë të matricës paraqiten ofruesit e produkteve dhe shërbimeve sipas llojit. Blerësit e produkteve dhe shërbimeve përfshihen sipas rreshtave të tabelës. Fillimisht, përfshihet konsumi i ndërmjetëm i sektorëve ekonomikë (pjesa e gjelbër), i cili nënkupton blerjet e sektorëve të ekonomisë për qëllime të prodhimit. Kujtojmë që konsumi i ndërmjetëm shërben për realizimin e produkteve dhe shërbimeve nga sektorët prodhues. Tabela është në formatin 2x2 për arsye thjeshtësimi, pasi janë 25 sektorë të ekonomisë të përfshirë në këto matrica.

Pjesa blu e matricës përfshin kërkesën finale për mallra dhe shërbime sipas llojeve. Blerësit në këtë rast janë konsumatorët publikë dhe privatë. Kërkesa finale ndahet në komponentët: konsum i popullatës, konsum publik dhe i organizatave jofitimprurëse, formimi i kapitalit (privat dhe publik së bashku), inventarë dhe eksport. Këtu duhet përmendur që matricat në fjalë janë "jokonkurruese", që nënkupton faktin se importet janë përfshirë së bashku me produktin vendas në gjithë strukturën e raportuar. Totali i konsumit të ndërmjetëm dhe kërkesës finale (totali sipas rreshtave) përbën produktin total sipas llojit. Të gjithë komponentët në fjalë janë raportuar me çmime tregu, që nënkupton çmime bazë plus taksat neto mbi produktet.

Komponenti me ngjyrë të kuqe në tabelat në fjalë përbën vlerën e shtuar sipas sektorëve të ekonomisë. Vlera e shtuar mund të shihet në dy këndvështrime. Sipas përjasjes së prodhimit përfshin produktin final të gjeneruar sipas sektorëve, ndërkohë që sipas përjasjes së të ardhurave përfshin të ardhurat për faktorët e prodhimit të përdorur. Për fat të keq, vlera e shtuar nuk paraqitet e disagreguar dhe në këtë mënyrë nuk është e mundur të evidentohen komponentët përbërës të të ardhurave (puna, kapitali, fitimi).

## 2.2 TABELA E BURIMEVE

Tabela e burimeve është paraqitur gjithashtu në Shtojcën 1. Ndryshe nga tabela e përdorimeve, në këtë tabelë paraqiten produktet dhe shërbimet e gjeneruara nga sektorët ekonomikë (pjesa e gjelbër). Duke qenë se sektorët ekonomikë prodhojnë kryesisht produktet ose shërbime sipas emërimit, vlerat janë të përqendruara në linjën diagonale të kësaj table. Nëse sektori gjeneron produkte ose shërbime të tjera, këto përfshihen në pjesën e nënprodukteve ose nënshërbimeve. Në pjesën e gjelbër përfshihen vetëm produktet e gjeneruar së brendshmi pa specifikuar llojin (konsum i ndërmjetëm apo produkt final).

Nëse produktit të brendshëm i shtohen importet kalohet në totalin e burimeve. Deri në këtë çast, statistikat raportohen me çmime bazë (para përfshirjes së taksave dhe marzheve). Duke shtuar taksat neto dhe marzhet mbi produktet kalohet nga çmime bazë (të shitësit) në çmime tregu (të blerësit).

### 2.3 TABELA INPUT-OUTPUT

Matrica në fjalë raportohet vetëm për vitin 2011. Kjo matricë bashkon burimet dhe përdorimet së bashku në një strukturë të vetme dhe raportohet me çmime bazë dhe taksa neto të diferencuara. Linja e transaksioneve është nga sektorët shitës (kolona e parë) në sektorët blerës dhe në kërkesën finale të blerësve. Në këtë rast, kërkesa finale është raportuar vetëm në totalin e saj dhe jo e diferencuar sipas komponentëve. Nga ana tjetër, importet janë paraqitur sipas sektorëve, por edhe në këtë rast nuk janë të ndarë në konsum të ndërmjetëm dhe kërkesë finale. Modeli i tabelës është paraqitur në Shtojcën 1.

## 3. MULTIPLIKATORËT

Multiplikatorët përbëjnë treguesit standardë që burojnë nga matricat kontabël. Në rastin konkret, multiplikatorët nënkuptojnë ndryshime të një komponenti total të ekonomisë (produkt, vlerë e shtuar, import ose PBB) në funksion të rritjes së kërkesës finale (Miller & Blair, 2009). Ndryshimi në fjalë përbën fillimin e mekanizmit të transmisionit dhe është ekzogjen. Më poshtë do të raportohen multiplikatorët e prodhimit, vlerës së shtuar, importit dhe PBB-së sipas sektorëve të ekonomisë dhe sipas komponentëve të kërkesës finale. Në këtë artikull, janë paraqitur vetëm multiplikatorët për vitin 2011, duke pasur parasysh që vlerat janë mjaft të ngjashme me vitet e tjerë.

### 3.1 MULTIPLIKATORËT E SEKTORËVE

Një prej përfitimeve më të rëndësishëm që burojnë nga statistikat e këtyre tabelave është aftësia për të modeluar dhe matur efekte të nxitura në ekonominë në tërësi, që i kanë fillimet në goditje ekzogjene. Në këtë rast, goditjet ekzogjene kanë të bëjnë me kërkesën finale sipas produkteve. Ndryshimet në komponentët e saj përbëjnë pikën e nisjes së ndryshimit dhe impaktin direkt.

Në sajë të ndryshimit të kërkesës për produktet ose shërbimet e një sektori, ndryshon aktiviteti ekonomik në këtë sektor. Prodhimi në këtë rast duhet t'i përgjigjet kërkesës së shtuar (ose pakësuar). Aktiviteti në rritje prodhuese do të shtojë kërkesën sektoriale për produktet dhe shërbime të ndërmjetme (të ofruara në funksion të gjenerimit të produktit vetjak), duke prodhuar në këtë mënyrë aktivitet në sektorët e tjerë të ekonomisë.

Aktiviteti i përgjithshëm i ndryshuar prodhon ndryshime shitesë në terma të vlerës së shtuar, që ka të bëjë me të ardhurat suplementarë të gjeneruar (për punë, kapital dhe fitim). Nga ana tjetër, nëse ekonomia e brendshme nuk është në gjendje të kënaqë kërkesën e re finale, në kuadër të ekonomisë së hapur, do të jenë importet ata që do të përgjigjen.

Duke filluar nga seksioni i mëposhtëm, do të paraqitet procedura e llogaritjes së multiplikatorëve, duke filluar me ata të prodhimit dhe duke vazhduar me vlerën e shtuar dhe importet. Vlerësimet do të zhvillohen sipas secilit prej 25



sektorëve (procedura e përgjithshme është e njëjtë) dhe viteve 2009-2011. Në fund, do të paraqiten edhe impaktet neto të rritjes së kërkesës sektoriale në terma të produktit të brendshëm.

### 3.1.1 Multiplikatorët e prodhimit

Multiplikatorët e prodhimit nënkuptojnë ndryshimin e produktit total në ekonomi si pasojë e rritjes së kërkesës finale të një sektori të caktuar me një njësi (në rastin konkret 1 lek). Ky efekt lidhet me lëvizje në terma të produktit të ndërmjetëm në ekonomi (lidhje në prapavijë), të cilit i shtohet ndryshimi fillestar i kërkesës finale të një sektori të caktuar për të prodhuar ndryshimin total të produktit.

Hapi i parë në llogaritjen e multiplikatorëve të produktit është vlerësimi i koeficientëve teknikë sektorialë, të cilët masin intensitetin e përdorimit të produkteve të ndërmjetme nga një sektor i veçantë në funksion të prodhimit të tij (prodhimi mund të shkojë për kërkesë finale ose konsum të ndërmjetëm). Formula e llogaritjes së koeficientëve teknikë ( $a_{ij}$ ) të prodhimit paraqitet më poshtë:

$$a_{ij} = z_{ij} / X_j$$

ku  $X_j$  është produkti  $i$  sektorit  $j$  dhe  $z_{ij}$  është konsumi i ndërmjetëm i sektorit  $j$  blerë nga sektori  $i$ . Kujtojmë që në këtë rast, transaksioni për konsum të ndërmjetëm mund të zhvillohet brenda të njëjtit sektor (mes firmave të këtij sektori).

Në këtë fazë disponojmë një matricë  $25 \times 25$  të koeficientëve teknikë e njohur si matrica A. Duke supozuar një matricë njësi I me elementë 1 në diagonale dhe 0 për pozicionet e tjera, gjenerohet seria diferencë  $I-A$  e njohur si matrica Leontief. Produkti total do të llogaritet nga shumëzimi i matricës së anasjellë Leontief  $(I-A)^{-1}$  me vektorin e ndryshimit të kërkesës finale (me 25 elementë në kolonë). Në këtë mënyrë, do të përftoheshin vlerat e multiplikatorëve sektorialë të prodhimit sipas sektorëve.

Vlerat e multiplikatorëve sektorialë për vitet 2009-2011 janë llogaritur sipas tabelës së përdorimeve. Edhe tabela input-output mund të përdoret për këtë qëllim, por duke pasur parasysh që është e disponueshme vetëm për vitin 2011, tabela e përdorimeve përbën një opsion më të përshtatshëm nëse kërkohet të vështrohet ecuria e multiplikatorëve në vite. Këto të dhëna janë paraqitur në shtojcën 1 sipas viteve dhe duke renditur sektorë sipas vlerave në rënie të multiplikatorëve.

Sipas multiplikatorëve të llogaritur në vite, ndërtimi, nxjerra e mineraleve joenergjetike dhe fabrikimi i artikujve të tjerë jometalikë janë sektorët me multiplikatorë më të lartë, që nënkupton një ndërlidhje më të fortë të tyre me sektorët në prapavijë. Nga ana tjetër, multiplikatorët më të vegjël pasqyrohen në rastin e industrisë së makinerisë dhe pajisjeve, industrive të tjera ushqimore dhe industrisë kimike dhe të kauçikut.

### 3.1.2 Multiplikatorët e vlerës së shtuar

Pas rritjes së kërkesës dhe ndryshimit të konsumit të ndërmjetëm, ekonomia është në gjendje të gjenerojë vlerë të shtuar, e parë në formë të produktit ose të ardhurave. Edhe në këtë rast, bëhet fjalë për rritje të vlerës së shtuar për gjithë ekonominë, si pasojë e rritjes së kërkesës finale në një sektor të caktuar me një njësi (1 lek).

Ashtu sikurse në rastin e prodhimit, procesi i gjenerimit të multiplikatorëve nis me koeficientët teknikë të vlerës së shtuar sipas sektorëve, të cilët llogariten si raport i vlerës së shtuar ndaj prodhimit total të sektorit. Në këtë mënyrë, gjenerohet një vektor me koeficientët teknikë të vlerës së shtuar, i cili nëse shumëzohet me matricën e ndryshimit të produktit vlerësuar në kuadër të prodhimit, jep elementët e multiplikatorit të vlerës së shtuar sektoriale.

Multiplikatorët e vlerës së shtuar janë paraqitur gjithashtu në Shtojcën 2, duke renditur në fillim sektorët me multiplikatorë më të lartë. Arsimi, bujqësia, administrata publike dhe mbrojtja kryesojnë, ndërkohë që në fund të renditjes dallohen industria e makinerive dhe pajisjeve, industri të tjera ushqimore dhe industria kimike dhe e kauçukut.

### 3.1.3. Multiplikatorët e importeve

Kujtojmë edhe njëherë se matricat në fjalë përfshijnë produktin vendas dhe importin së bashku. Në këtë mënyrë, nëse rritja e kërkesës finale nuk do të kënaqet nga tregu vendas, në kuadër të ekonomisë së hapur, do të kënaqet nga importi. Multiplikatorët e importit nënkuptojnë rritjen e importeve në gjithë ekonominë, si pasojë e rritjes me një njësi të kërkesës finale të një sektori të caktuar.

Edhe në rastin e importeve, tabelat janë në gjendje të gjenerojnë koeficientë teknikë shprehur si raporti i importit sektorial ndaj produktit sektorial. Ashtu si në rastin e vlerës së shtuar, vektori i koeficientëve teknikë të importit shumëzohet me matricën e ndryshimit të produktit për të marrë ndryshimet dhe multiplikatorët përkatës të importeve.

Multiplikatorët në fjalë janë paraqitur në Shtojcën 2. Renditja e sektorëve është diametrikisht e kundërt me rastin e vlerës së shtuar. Sektorët me impakt më të fortë do të ishin makineritë, produktet e tjera ushqimore dhe industria kimike dhe e kauçukut. Nga ana tjetër, më pak impakt në importe do të kishte bujqësia, administrata publike dhe arsimi.

### 3.1.4 Multiplikatorët e PBB-së

Efekti në PBB për çdo sektor llogaritet, duke i shtuar rritjes fillestare të kërkesës finale vlerën e shtuar të gjeneruar dhe duke zbritur impaktin e importeve. Multiplikatorët e PBB-së janë paraqitur në shtojcën 2. Sektorët që do të kishin efekt më të fortë në PBB janë ata me ndikim të fortë në vlerë të shtuar dhe ndikim të ulët në importe. Bujqësia, administrata publike dhe arsimi radhiten

të parët, ndërkohë që makineritë, produktet e tjera ushqimore dhe industria kimike dhe e kauçikut renditen në fund.

### 3.2 MULTIPLIKATORËT E KOMPONENTËVE TË KËRKESËS FINALE

Ashtu sikurse në rastin e sektorëve të ekonomisë, multiplikatorët e kërkesës finale nënkuptojnë rritjet përkatëse në produkt, vlerë të shtuar, importe dhe PBB-në në gjithë ekonominë, si pasojë e rritjes së komponentit me një njësi (1 lek). Në këtë rast nuk bëhet fjalë për një sektor të vetëm, pasi kërkesa finale sipas komponentëve është e shpërndarë sipas kategorive të produkteve, duke pasur parasysh strukturat përkatëse të komponentëve në vitet përkatëse.

Multiplikatorët e komponentëve të kërkesës finale janë paraqitur në Shtojcën 3. Megjithëse në terma të produktit total, investimet dhe konsumi i popullatës janë sektorët me impakt më të fortë në ekonomi. Përsa i përket impaktit në PBB, konsumi publik renditet në vend të parë. Kjo vjen për shkak të një ndikimi më të fortë të këtij të fundit në vlerë të shtuar, ndërkohë që në rastin e konsumit të popullatës dhe investimeve shtohet baraspesha mes vlerës së shtuar dhe importeve. Eksportet nga ana tjetër, kanë ndikimin më të vogël për shkak të mbizotërimit të importeve.

Në këtë pikë, duhet theksuar se multiplikatorët në fjalë kanë të bëjnë me efekte të përcaktuara dhe individuale të rritjes ekzogjene të kërkesës finale (komponentëve), në terma të prapavijës (*backward linkages*). Këta multiplikatorë nuk përfshijnë efekte të raundit të dytë ose të tretë të gjenerimit të kërkesës finale suplementare (*forward linkages*).

### 3.3 KËRKESA FINALE: STRUKTURA DHE KONTRIBUTI

Në këtë pikë, është e nevojshme të shpjegohet se përse multiplikatorët e komponentëve të kërkesës finale prodhojnë peizazhin e përshkruar më lart. Për të realizuar këtë, është e nevojshme që kërkesa dhe produkti sektorial të bashkohen për të lidhur multiplikatorët në fjalë me përbërësit (sipas sektorëve) të komponentëve të kërkesës.

Në Shtojcën 4, paraqiten grafikët që i korrespondojnë komponentëve të kërkesës finale. Në brendësi të secilit grafik, përfshihen vlerat e multiplikatorëve të efektit neto në PBB dhe peshës që sektorët përkatës të ekonomisë zënë ndaj totalit të komponentit në fjalë. Sipas këtij formati, mund të shpjegohet multiplikatori total i llogaritur në funksion të multiplikatorëve sektorialë të përbërjes së komponentëve të kërkesës. Secili grafik është i pajisur me një vijë lineare të trendit të shpërndarjes. Një orientim i drejtëzave në drejtim verilindje-jugperëndim, pasqyron një përqendrim të strukturës së komponentit në sektorë me multiplikatorë relativisht më të lartë të PBB-së. Sa më e pjerrët të jetë drejtëza aq më i theksuar është fenomeni dhe për rrjedhojë, aq më i lartë do të rezultojë multiplikatori i përgjithshëm. Nga ana tjetër, një drejtëz me orientim veriperëndim-juglindje do të tregonte mbizotërimin e degëve me multiplikatorë relativisht më të vegjël të PBB-së.

Për shembull, në rastin e konsumit publik vihet re një mbizotërim i dukshëm i sektorëve me multiplikator të lartë dhe që të gjithë shfaqin një multiplikator më të lartë se 1. Në rastin e konsumit të popullatës dhe formimit të kapitalit (publik dhe privat së bashku) shfaqen drejtëza me orientimin e duhur, por me pjerrësi të vogël. Në këto raste, përsëri mbizotërojnë sektorët me multiplikatorë relativisht më të lartë, por fenomeni është më pak i dukshëm. E njëjta situatë vlen edhe në rastin e kërkesës së brendshme.

Në rastin e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, drejtëza ka orientim të kundërt. Në këtë rast, kërkesa për eksporte është e përqendruar në sektorë me multiplikatorë relativisht të lartë të importeve dhe për rrjedhojë relativisht të ulët të vlerës së shtuar dhe PBB-së. Në veçanti, bëhet fjalë për degët e tekstileve, metaleve, transportit dhe hotele-restoranteve.

Së fundi, kërkesa totale finale (shuma e kërkesës së brendshme dhe eksporteve) shfaq cilësi të ngjashme me kërkesën e brendshme. Në këtë rast, prania e eksporteve nuk ka ndikuar në përmbyshjen e kërkesës totale kur i shtohet kërkesës së brendshme.

#### 4. KONSUMI I NDËRMJETËM DHE PRODUKTI TOTAL

Konsumi i ndërmjetëm përbën ndoshta një nga elementët që tërheqin më pak vëmendjen në studimet e llogarive kombëtare. Kjo mbase vjen për faktin se përqendrimi është më tepër i orientuar nga kërkesa finale dhe shpesh harrohet komponenti që ndikon në gjenerimin e kërkesës finale.

Tabelat e kontabilitetit social japin një pasqyrë mjaft të larmishme të konsumit të ndërmjetëm dhe janë në gjendje të parashtrajnë ndërlidhje ekonomike të strukturës tërësore, të cilat bartin ndikime pozitive ose rreziqe. Në matricën e konsumit të ndërmjetëm, tërësia e sektorëve blerës është e njëjtë me tërësinë e sektorëve shitës.

Në Shtojcën 5 paraqiten dy grafikë të përbërjes së konsumit të ndërmjetëm që ngjajnë me grafikët e strukturës. Grafiku i parë sipas blerësve, paraqet peshat e sektorëve blerës të konsumit të ndërmjetëm së bashku me multiplikatorët përkatës të PBB-së. Orientimi i drejtëzës tregon se konsumatorët janë sektorët me multiplikatorë relativisht më të lartë të PBB-së. Nga ana tjetër, struktura sipas shitësve shfaq një drejtëz me orientim të kundërt, duke treguar se ofruesit më të mëdhenj kanë edhe multiplikatorë më të ulët të PBB-së dhe për rrjedhojë me mbështetje më të lartë në importe. Në mënyrë të veçantë, kontributi për këtë situatë vjen nga sektorët e përpunimit të lëndës djegëse, produkte jometalore, metaleve, makineri-pajisje dhe drurit dhe letrës.

Grafiku i produktit total të ofruar, i cili bashkon konsumin e ndërmjetëm sipas shitësve dhe kërkesës finale paraqitet gjithashtu në Shtojcën 5. Orientimi i drejtëzës tregon për një mbizotërim në strukturë të atyre sektorëve me multiplikatorë relativisht më të ulët në PBB. Më konkretisht, kontributi kryesor vjen nga makineri-pajisje, lënda djegëse, drithërat, tekstilet, druri dhe letra,

industria kimike dhe transporti. Disa degë me multiplikatorë dhe peshë relativisht të lartë në strukturë sikurse ndërtimi, bujqësia, aktivitetet e pasurive të paluajtshme dhe qirasë. Megjithatë, fakti i mbështetjes sektoriale për konsum të ndërmjetëm në burime me multiplikatorë të lartë importi përbën sigurisht një element rreziku strukturor për ekonominë.

## 5. PËRFUNDIME DHE DISKUTIME

Në këtë material janë prezantuar statistikat më të fundit të llogarive kombëtare që lidhen me tabelat burime-përdorime dhe input-output. Këto statistika raportojnë tërësinë e transaksioneve të zhvilluara gjatë një viti për ekonominë tonë në periudhën 2009-2011, në terma nominalë. Në këtë material, përshkrimi i përgjithshëm i karakteristikave të tre llojeve të tabelave është shoqëruar me llogaritjen e multiplikatorëve përkatës.

Në rastin e multiplikatorëve, duke zbatuar parimet bazë të modelimit sipas Leontief, janë llogaritur multiplikatorët sektorialë për prodhimin, vlerën e shtuar dhe importet. Këta multiplikatorë më pas, janë përdorur për të identifikuar efektet neto në terma të produktit të brendshëm, si pasojë e ndryshimeve ekzogjene të kërkesës sektoriale. Në terma të produktit të gjeneruar, sektorët më të ndërlidhur janë ndërtimi, fabrikimi i artikujve jometalikë dhe nxjerrja e mineraleve joenergjetikë, ndërkohë që sektorët më pak të lidhur janë makineri-pajisje, industria kimike dhe industri të tjera ushqimore.

Nëse shtohen elementët e vlerës së shtuar dhe importit për të llogaritur impakte neto në produktin e brendshëm, sektorët e renditur më lart janë arsimi, administrata publike dhe bujqësia, ndërkohë që sektorët me impakt më të ulët janë makineri-pajisje, industria kimike dhe industri të tjera ushqimore.

Përveç multiplikatorëve sektorialë, janë llogaritur gjithashtu multiplikatorët për komponentët e kërkesës finale dhe për kërkesën në tërësi. Këto llogaritje janë shoqëruar me disa përshkrime në lidhje me strukturat sektoriale të kërkesës për komponentët e saj. Sipas këtyre multiplikatorëve, komponentët me ndikim më të lartë në produktin e brendshëm janë konsumi publik dhe ai i organizatave jofitimprurëse. Konsumi i popullatës dhe formimi i kapitalit shfaqin impakt të ndërmjetëm, ndërkohë që impakt më të ulët shfaqin eksportet.

Analiza e përbërjes së komponentëve të kërkesës, zbulon arsyen e nxjerrjes së këtyre multiplikatorëve. Në rastin e konsumit publik, shfaqet një përqendrim i kërkesës në sektorë me impakt të lartë në PBB. Nga ana tjetër, konsumi i popullatës dhe formimi i kapitalit shfaqin shpërndarje pothuaj identike mes llojit të sektorëve. Në rastin e eksporteve, mbizotërojnë sektorët me multiplikatorë relativisht të lartë të importeve dhe të ulët të PBB-së.

Në terma të kërkesës finale dhe konsumit të ndërmjetëm, analiza e strukturave përkatëse tregon dy histori të ndryshme. Në rastin e kërkesës finale, orientimi i kërkesës është drejt atyre sektorëve me multiplikatorë relativisht më të lartë. Nga ana tjetër, konsumi i ndërmjetëm sipas shitësve tregon mbështetjeje të

sektorëve, ku mbizotërojnë direkt ose indirekt importet. Produkti total anon në një drejtim të ngjashëm (por më të balancuar), sikurse konsumi i ndërmjetëm duke zbuluar një rrezik strukturor të ekonomisë.

Në lidhje me përdorimet e mundshme të statistikave në fjalë, përveç analizës së përgjithshme bazuar mbi multiplikatorët e përshkruar më sipër, modelet e ekuilibrit të përgjithshëm statik (linear) kontabël përbëjnë orientimin më të njohur dhe të përhapur. Gjithashtu, analizat e impaktit dhe strukturimet industriale janë sigurisht të lidhura me një njohje të qartë të strukturës ekonomike, e cila nuk mund të përshkruhet më mirë se nga këto statistika.

Megjithatë, statistikat përkatëse të Shqipërisë janë ende në fazat e tyre fillestare dhe mungesa e elementëve realë (me çmime konstante) në parametrat e raportuar shmang hapësira më të gjera analitike. Mendohet që këto statistika do të pasurohen dhe shtohen në të ardhmen, duke rritur gjithnjë e më tepër spektrin e analizave të mundshme dhe përdorimeve që burojnë prej tyre.

## BIBLIOGRAPHY

INSTAT. (2014). *Tabelat burime-përdorime dhe input-output në Shqipëri, 2009-2011*. Tiranë: INSTAT. Retrieved from [http://www.instat.gov.al/media/280637/tbp\\_2009-2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/280637/tbp_2009-2011.pdf)

Leontief, W. W. (1936, August). *Quantitative Input and Output Relations in the Economic Systems of the United States*. *The Review of Economics and Statistics*, 18(3), 105-125. doi:10.2307/1927837

Miller, R. E., & Blair, P. D. (2009). *Input-Output Analysis (2nd ed.)*. New York, United States of America: Cambridge University Press.

## SHTOJCA 1

Tabela e përdorimeve

	Konsumi i ndërmjetëm		Kërkesa finale						Përdorime totale
	Industri blerëse 1	Industri shitëse 2	Konsum i popullatës	Konsum publik dhe i OJF	Formimi i kapitali	Inventar	Eksporti	Totali i kërkesës finale	Produkti total
Industritë shitëse 1	X11	X12							
Industritë shitëse 2	X21	X22							
Vlera e shtuar	V1	V2							

Tabela e burimeve

		Industria 1	Industri 2	Totali sipas produkteve me çmime bazë	Importe (FOB)	Totali i burimeve me çmime bazë	Taksa neto mbi produktet	Marzhi tregtar dhe i transportit	Totali i burimeve me çmime tregu
Produkte	Produkti 1	Produkti 11	Nënprodukt 21						
	Produkti 2	NënProdukti 12	Produkti 22						

Tabela input-output

	Industria 1	Industria 2	Totali i konsumit të ndërmjetëm sipas produkteve	Kërkesa finale	Totali i burimeve
Industria 1	X11	X12	X11+X12	FD1	Totali i burimeve 1
Industria 2	X21	X22	X21+X22	FD2	Totali i burimeve 2
Totali i konsumit (çmime bazë)	X11+X21	X12+X22	Totali i konsumit të ndërmjetëm (çmime bazë)	Totali i kërkesës finale (çmime bazë)	Totali i burimeve (çmime bazë)
Taksa neto mbi produktet	Taksa mbi konsumin e ndërmjetëm 1	Taksa mbi konsumin e ndërmjetëm 2	Taksa totale mbi konsumin e ndërmjetëm	Taksa mbi kërkesën finale	Totali i taksave
Totali i konsumit të ndërmjetëm sipas aktiviteteve (çmime tregu)	IC1	IC2	Totali i konsumit të ndërmjetëm (çmime tregu)	Kërkesa finale (çmime tregu)	Totali i burimeve (çmime tregu)
Vlera e shtuar	V1	V2	Totali i vlerës së shtuar		
Totali i produktit vendas	P1	P2	Totali i produktit të brendshëm		
Importet (FOB)	I1	I2	Totali i importit		
Totali i përdorimeve	Përdorime 1	Përdorime 2	Totali i përdorimeve		



## SHTOJCA 2

*Multiplikatorët e prodhimit sipas sektorëve (viti 2009)*

Sektori	Multiplikatori
Ndërtimi	2.23
Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	1.84
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	1.77
Peshkimi	1.83
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	1.54
Posta dhe komunikacion	1.54
Industria e përpunimit të drithërave	1.46
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	1.55
Transport	1.45
Hotele dhe restorante	1.52
Administrata publike dhe e mbrojtjes	1.42
Tregtia	1.45
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	1.60
Nxjerrja e mineraleve energjetike	1.32
Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	1.40
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.30
Aktivitete financiare	1.31
Shëndeti	1.35
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	1.43
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	1.25
Industria e tekstileve dhe lëkurës	1.38
Arsimi	1.30
Industria kimike dhe e kauçikut	1.22
Industri të tjera të produkteve ushqimore	1.04
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	1.03

*Multiplikatorët e prodhimit sipas sektorëve (viti 2010)*

Sektor	Multiplikatori
Ndërtimi	2.06
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	1.85
Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	1.74
Peshkimi	1.86
Posta dhe komunikacion	1.68
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	1.51
Industria e përpunimit të drithërave	1.53
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	1.46
Transport	1.46
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	1.68
Administrata publike dhe e mbrojtjes	1.49

Tregtia	1.46
Hotele dhe restorante	1.40
Aktivite mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	1.40
Shëndeti	1.42
Nxjerrja e mineraleve energjetike	1.40
Aktivite financiare	1.47
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.29
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	1.25
Industria e tekstileve dhe lëkurës	1.18
Arsimi	1.36
Industria kimike dhe e kauçukut	1.27
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	1.21
Industri të tjera të produkteve ushqimore	1.08
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	1.03

### *Multiplikatorët e prodhimit sipas sektorëve (viti 2011)*

Sektor	Multiplikatori
Ndërtimi	2.12
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	1.94
Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	1.9
Peshkimi	1.85
Posta dhe komunikacion	1.76
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	1.71
Transport	1.55
Industria e përpunimit të drithërave	1.52
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	1.49
Tregtia	1.48
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	1.47
Administrata publike dhe e mbrojtjes	1.44
Aktivite mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	1.42
Aktivite financiare	1.38
Hotele dhe restorante	1.38
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	1.38
Nxjerrja e mineraleve energjetike	1.37
Shëndeti	1.36
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.36
Industria e tekstileve dhe lëkurës	1.3
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	1.26
Arsimi	1.26
Industria kimike dhe e kauçukut	1.23
Industri të tjera të produkteve ushqimore	1.11
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	1.03

*Multiplikatorët e vlerës së shtuar sipas sektorëve (viti 2009)*

Sektor	Multiplikatori
Arsimi	0.88
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.86
Administrata publike dhe e mbrojtjes	0.82
Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0.81
Tregtia	0.75
Posta dhe komunikacion	0.66
Aktivitete financiare	0.66
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0.65
Nxjerrja e mineraleve energjetike	0.63
Shëndeti	0.6
Ndërtimi	0.59
Peshkimi	0.58
Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	0.56
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0.51
Hotele dhe restorante	0.43
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0.37
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	0.37
Industria e përpunimit të drithërave	0.36
Transport	0.34
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.28
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.19
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.17
Industria kimike dhe e kauçikut	0.09
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.03
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.03

*Multiplikatorët e vlerës së shtuar sipas sektorëve (viti 2010)*

Sektor	Multiplikatori
Arsimi	0.86
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.86
Administrata publike dhe e mbrojtjes	0.81
Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0.79
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0.76
Tregtia	0.73
Nxjerrja e mineraleve energjetike	0.71
Aktivitete financiare	0.69
Posta dhe komunikacion	0.63
Shëndeti	0.62
Ndërtimi	0.6

Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	0.57
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0.54
Peshkimi	0.54
Hotele dhe restorante	0.44
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	0.39
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0.36
Transport	0.36
Industria e përpunimit të drithërave	0.36
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.28
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.19
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.1
Industria kimike dhe e kauçukut	0.08
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.06
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.03

### *Multiplikatorët e vlerës së shtuar sipas sektorëve (viti 2011)*

Sektor	Multiplikatori
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.86
Administrata publike dhe e mbrojtjes	0.83
Arsimi	0.83
Aktivite mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0.79
Tregtia	0.73
Nxjerrja e mineraleve energjetike	0.72
Aktivite financiare	0.69
Shëndeti	0.62
Posta dhe komunikacion	0.61
Ndërtimi	0.6
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0.57
Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	0.55
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0.53
Peshkimi	0.52
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	0.41
Hotele dhe restorante	0.41
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0.37
Transport	0.36
Industria e përpunimit të drithërave	0.34
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.29
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.2
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.14
Industria kimike dhe e kauçukut	0.09
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.08
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.02

*Multiplikatorët e importit sipas sektorëve (2009)*

Sektor	Multiplikatori
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.97
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.97
Industria kimike dhe e kauçukut	0.91
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.83
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.81
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.72
Transport	0.66
Industria e përpunimit të drithërave	0.64
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	0.63
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0.63
Hotele dhe restorante	0.57
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0.49
Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	0.44
Peshkimi	0.42
Ndërtimi	0.41
Shëndeti	0.4
Nxjerrja e mineraleve energjetike	0.37
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0.35
Aktivitetet financiare	0.34
Posta dhe komunikacion	0.34
Tregtia	0.25
Aktivitetet mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0.19
Administrata publike dhe e mbrojtjes	0.18
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.14
Arsimi	0.12

*Multiplikatorët e importit sipas sektorëve (2010)*

Sektor	Multiplikatori
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.97
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.94
Industria kimike dhe e kauçukut	0.92
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.9
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.81
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.72
Industria e përpunimit të drithërave	0.64
Transport	0.64
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0.64
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	0.61

Hotele dhe restorante	0.56
Peshkimi	0.46
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0.46
Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	0.43
Ndërtimi	0.4
Shëndeti	0.38
Posta dhe komunikacion	0.37
Aktivitetet financiare	0.31
Nxjerrja e mineraleve energjetike	0.29
Tregtia	0.27
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0.24
Aktivitetet mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0.21
Administrata publike dhe e mbrojtjes	0.19
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.14
Arsimi	0.14

### *Multiplikatorët e importit sipas sektorëve (2011)*

Sektor	Multiplikatori
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.98
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.92
Industria kimike dhe e kauçukut	0.91
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.86
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.8
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.71
Industria e përpunimit të drithërave	0.66
Transport	0.64
Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0.63
Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	0.59
Hotele dhe restorante	0.59
Peshkimi	0.48
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0.47
Nxjerrja e mineraleve joenergjetike	0.45
Shëndeti	0.43
Ndërtimi	0.4
Posta dhe komunikacion	0.39
Aktivitetet financiare	0.38
Nxjerrja e mineraleve energjetike	0.31
Tregtia	0.28
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0.27
Aktivitetet mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0.21
Administrata publike dhe e mbrojtjes	0.17
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.17
Arsimi	0.14

## Multiplikatorët e PBB-së sipas sektorëve

2009		2010		2011	
Arsimi	1.76	Arsimi	1.73	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.72
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.71	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.73	Administrata publike dhe e mbrojtjes	1.66
Administrata publike dhe e mbrojtjes	1.63	Administrata publike dhe e mbrojtjes	1.63	Arsimi	1.65
Pasuri të patundshme, qira dhe shërbime për ndërmarrjet	1.61	Pasuri të patundshme, qira dhe shërbime për ndërmarrjet	1.57	Pasuri të patundshme, qira dhe shërbime për ndërmarrjet	1.58
Tregtia	1.5	Energjia elektrike dhe gazi	1.52	Tregtia	1.47
Posta dhe komunikacion	1.33	Tregtia	1.46	Nxjerrja e mineraleve energjetike	1.44
Aktivite financiare	1.32	Nxjerrja e mineraleve energjetike	1.43	Aktivite financiare	1.38
Energjia elektrike dhe gazi	1.3	Aktivite financiare	1.39	Shëndeti	1.23
Nxjerrja e mineraleve energjetike	1.27	Posta dhe komunikacion	1.25	Posta dhe komunikacion	1.23
Shëndeti	1.19	Shëndeti	1.24	Ndërtimi	1.19
Ndërtimi	1.19	Ndërtimi	1.2	Energjia elektrike dhe gazi	1.14
Peshkimi	1.16	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	1.13	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	1.09
Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	1.11	Shërbime kolektive, sociale dhe personale	1.09	Shërbime kolektive, sociale dhe personale	1.06
Shërbime kolektive, sociale dhe personale	1.02	Peshkimi	1.08	Peshkimi	1.03
Hotele dhe restorante	0.85	Hotele dhe restorante	0.89	Artikuj të tjerë mineralë jo metalikë	0.82
Druri, letra, mobilje dhe publikim	0.74	Artikuj të tjerë mineralë jo metalikë	0.79	Hotele dhe restorante	0.81
Artikuj të tjerë mineralë jo metalikë	0.74	Druri, letra, mobilje dhe publikim	0.73	Druri, letra, mobilje dhe publikime	0.74
Industria e përpunimit të drithërave	0.73	Transport	0.72	Transport	0.71
Transport	0.67	Industria e përpunimit të drithërave	0.71	Industria e përpunimit të drithërave	0.68
Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.56	Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.56	Industria e tekstileve dhe lëkurës	0.58
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.37	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.39	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0.4
Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.34	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.2	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0.28
Industria kimike dhe e kauçikut	0.18	Industria kimike dhe e kauçikut	0.16	Industria kimike dhe e kauçikut	0.18
Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.06	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.13	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0.16
Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.05	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.06	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0.04

## SHTOJCA 3


*Multiplikatorët e komponentëve të kërkesës finale*

Komponenti i kërkesës	2009				
	% ndaj totalit	Produkti	Vlerë e shtuar	Import	GDP
Konsum publik	7.21%	1.37	0.8	0.2	1.6
Konsum i OJF	0.01%	1.45	0.58	0.42	1.17
Konsum i popullatës	50.13%	1.42	0.53	0.47	1.05
Investime	22.09%	2.02	0.5	0.5	1.01
Eksport	18.95%	1.47	0.47	0.53	0.94
Inventar	1.49%	1.5	0.3	0.7	0.6
Kërkesa e brendshme	81.05%	1.56	0.5	0.5	1.01
Kërkesa finale	100%	1.58	0.54	0.46	1.08
	2010				
Konsum publik	7.29%	1.39	0.78	0.22	1.57
Konsum i OJF	0.12%	1.44	0.61	0.39	1.21
Konsum i popullatës	50.63%	1.42	0.53	0.47	1.06
Investime	19.00%	1.87	0.51	0.49	1.02
Eksport	21.2%	1.46	0.47	0.53	0.95
Inventar	1.76%	1.51	0.33	0.67	0.65
Kërkesa e brendshme	78.8%	1.53	0.54	0.46	1.09
Kërkesa finale	100%	1.5	0.5	0.5	1.01
	2011				
Konsum publik	6.97%	1.37	0.78	0.22	1.56
Konsum i OJF	0.13%	1.47	0.58	0.42	1.16
Konsum i popullatës	50.13%	1.42	0.51	0.49	1.03
Investime	19.16%	1.9	0.5	0.5	1
Eksport	21.7%	1.48	0.46	0.54	0.92
Inventar	1.91%	1.5	0.32	0.68	0.65
Kërkesa e brendshme	78.3%	1.54	0.53	0.47	1.06
Kërkesa finale	100%	1.52	0.51	0.49	1.03




## SHTOJCA 4

### Struktura e komponentëve të kërkesës finale sipas sektorëve



### SHTOJCA 5

#### Struktura e konsumit të ndërmjetëm



#### Struktura e produktit total

